

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

BULETINI SHKENCOR

EDICION SPECIAL 2017

ISSN 2310-6719



KONFERENCË STUDENTORE E HAPUR

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË

VLORË, 14 DHJETOR 2017

Komiteti shkencor

Dr. Migena Balla

Dr. Aurora Bakaj

Dr. Jonada Zyberaj

Dr. Alketa Hyso.

Prof.dr. Yllka Stramarko

Dr. Fatjona Kamberi

Dr. Shkëlqim Sinanaj

Dr. Aurela Bifsha

Komiteti organizativ

PhD Enkelejd Mëhilli

Dr. Migena Balla

Dr. Erjona Dervishaliaj

Prof.as.dr. Bledar Toska

Daron Tozaj

Ornela Korçari

Përmbajtja

<i>Sëmundjet Tumorale më të Përhapura në Qytetin e Vlorës</i>	
Joana Rjepaj.....	7
<i>Efikasiteti i orës së mësimit nëpërmjet përdorimit të mjeteve objektive dhe procedurave shkencore</i>	
Anxhela Hazizi, Xhejni Leskaj, Bledar Pepa.....	8
<i>Anxiety in Breast Cancer, How Well Informed Are Women</i>	
Anxhela Jahaj, Juela Dahri, Ina Nasto.....	8
<i>Përqëndrimi i Magnezit në Serum dhe Eritrocit në Pacientët me Hipertension Arterial</i>	
Bruna Musaj.....	9
<i>Rëndësia Ornitologjike e Kripores së Nartës (Vlorë)</i>	
Endora Çelohoxhaj.....	10
<i>Të Dhënat Ekologjike dhe Sistematike të Peshqve të Lumit të Vjosës</i>	
Geolind Çobaj, Bledar Pepa.....	11
<i>Infeksionet e Traktit Urinar</i>	
Klea Bombaj.....	12
<i>Përvijime të Florës e Bimësisë në Gadishullin e Porto Palermos (Himarë)</i>	
Klea Duro.....	12
<i>Impakti që Japin Rrjetet Sociale në Proçesin e Mësimnxënies dhe në jetën e Nxënësve të Grupmohave 12-16 Vjeç</i>	
Laureta Sadikllari, Amarilda Rapaj, Ilva Alushi.....	13
<i>Hartëzimi Ishpërndarjes së Gropave Septike, Mbeturinae Urbane dhe Inerte, Përgjatë Vijës Bregdetare Dhërmi- Himarë</i>	
Lorela Pashaj, Ferdinand Ismailaj, Ilva Alushi.....	14
<i>Some Preliminary Data for the Evaluation of Waters Quality in Narta and Orikum Lagoons Using Frogs as Bioindicators, Vlora, Albania</i>	
Natasha Aliu, Arta Lugaj, Blerta Laze.....	15
<i>Preliminary Data on the Presence of Cyberbullying in Several Schools in Vlora, Albania</i>	
Ujeza Fezaj, Enxhi Lulaj, Ina Nasto.....	16
<i>Roli i Logopedëve në Lidhje me Terapinë dhe Rehabilitimin e Sëmundjeve Neurodegenerative</i>	
Maria Ramaj.....	16
<i>Roli ynë si Infermier në Fenomenin e Bullizmit në Shkolë dhe Shoqeri</i>	
Elira Lamce.....	17
<i>Shëndetësia Falas</i>	
Emerlinda Lame, Fjorentin Harizi, Florin Ibrahim, Nustil Ali.....	18

<i>Roli i Infermierit në Vetë-Menaxhimin e Diabetit Tipi 2: Rishikim Literature</i>	
Jonida Çeloaliaj, Velide Pulomemoj, Fatjona Kamberi.....	19
<i>Sigurimi i Kujdesit më të Mirë Shëndetësor të Mundshëm për Pacientet Bazuar në Patient Health Questionnaire (Phq): Implikime për Praktikën</i>	
Velide Pulomemoj, Jonida Çeloaliaj, Fatjona Kamberi.....	19
<i>Menaxhimi i Dhimbjes në Repartin e Urgjencës</i>	
Fjorida Koromani, Eva Muhaj.....	20
<i>Vlerësimi i Statusit Nutricional Dhe Rrezikut për Malnutricion te Pacientët e Moshuar të Hospitalizuar</i>	
Suada Golaj.....	21
<i>Vlerësimi i Njohurive dhe Qëndrimeve për IST, HIV/AIDS tek Studentët e Infermierisë</i>	
Elda Shahinaj.....	22
<i>Grupet Bashkëtingëllore në Pejë me Rrethinë</i>	
Arizona Lajçi, Ermira Mehmeti.....	22
<i>Njësitë Frazheologjike në Romanin "Kronikë Në Gur" të I. Kadaresë</i>	
Aurora Koçi.....	23
<i>Lidhëzat në periudhat me sifjali plotësore (kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore dhe përcaktore)</i>	
Albana Zeka.....	24
<i>Ngjyresat Krahinore në Mjediset Shkollore në Deçan</i>	
Rajmonda Dacaj.....	25
<i>Rreth veprës "Dranja" të autorit Martin Camaj</i>	
Alma Stuja, Besarta Dakaj, Alba Macula	26
<i>Rreth "Çetës Së Profetëve" të Pjetër Bogdanit</i>	
Arbër Malota, Fatjona Gashi.....	26
<i>Një vështrim mbi fjalëformimin në gramatikat e shqipes</i>	
Elsa Boshku.....	27
<i>Shtesat dhe Rëniet e Tingujve në të Folmen e Hasit të Prizrenit në Përqasje me Gjuhën Shqipe</i>	
Endresa Duraj.....	28
<i>Udhëtim në Fund të Natës" si Eksperiment i Jetës Njerëzore, si Realitet Tërësisht i Jashtëm, Humbja e Vetëdijes, Turpit dhe Koncepteve</i>	
Enxhi Hoxha.....	28
<i>Simboli, Guri Themeltar i Shprehjes Gjuhësore të Veprës së Buxatit</i>	
Eraldo Hatija.....	29
<i>Shqyrtim Semantik i Disa Fjalëve dhe Frazheologjizmave në Deçan dhe Rrethinë</i>	
Ermerinda Zekaj.....	30
<i>Sintagma Emërore dhe Veçori Semantike në veprën e Rebi Alikaj</i>	
Ersila Hoxha.....	31

<i>Një Vështrim Psikolinguistik i Lapsuseve në Gjuhën Shqipe</i>	
Esma Allmuça.....	31
<i>Krugët Sociolinguistike për Formimin e Shqipes Standarde</i>	
Fahrije Smakiqi.....	32
<i>Përemri Pronor Sipas Gramatikave të Gjuhës Shqipe</i>	
Grisilda Telhaj.....	33
<i>Ligjërimi Politik (Trajtëm të Aspekteve Teorike, Zbatimi i Tyre në Fjalimin e “Lamtumirës”, Ndikimi i Ligjërimin Politik në Shoqëri.)</i>	
Habi Hoxha.....	34
<i>Motivet Biblike dhe Përkthimi i Censuruar i Romanit “Robinson Kruzo” i Daniel Defosë</i>	
Ledio Hala.....	34
<i>Një Vështrim Historik i Kategorisë së Rasës në Gjuhën Shqipe</i>	
Myzejen Kashari.....	35
<i>Përdorimi i Zanores – Ë – Fundore në Punët me Shkrim (Kl. 8-9)</i>	
Nevruze Bollobani, Rexhersa Xheka.....	36
<i>Dritëro Agolli Poet i Tokës - (Rasti: “Të Pagjumët” Dhe “Lypësi i Kohës”)</i>	
Rovena Vata.....	37
<i>Ëndrra si reflektimi i të brendshmes, të fshehtës dhe mistikes në romanin “Lumi i Vdekur” i Jakov Xoxës</i>	
Ana Shahini	37
<i>Kontributi i revistës “Albania” në albanologji</i>	
Anita Tafani.....	38
<i>Gabimet Drejt Shkrimore e të Rinjve në Rrjete Sociale</i>	
Donika Baku.....	39
<i>Rendi i Përbërësve në Fjalitë Dëshirore (Mbështetur në Romanet “Lumi i Vdekur” Dhe “Juga e Bardhë” të Jakov Xoxës)</i>	
Elgert Dhima.....	39
<i>Zhvillimi dhe Pasurimi i Leksikut të Shqipes (Përmes Veprave ‘Apologji E Skënderbeut, ‘Oxhaku’ ‘Qyteti Pa Reklama’)</i>	
Evgjeni Selimaj.....	40
<i>Poetika Shqipe Sipas Sabri Hamitit</i>	
Fitim Velu.....	42
<i>Vështrim Krahasues i të Folmes së Fierit dhe Tropojës</i>	
Gentjana Ukcama.....	42
<i>Gjuha që Përdorin të Rinjtë në Facebook, Si Pjesë e Rrjeteve Sociale</i>	
Nevila Naka.....	43

<i>E-Learning in Higher Education Institutions in Europe</i>	
Albulena Veseli.....	43
<i>Bilingualism and Its Effect on Expanding Cultural Background</i>	
Saranda Berisha.....	44
<i>Hermetizmi në poezinë bashkëkohore shqipe</i>	
Manjola Ramo.....	45
<i>Riprodhimi artificial</i>	
Andi Bërdëllima.....	45
<i>Birësimi transracial</i>	
Anxhela Alliu.....	46
<i>Censura në Fokusin e Pronësisë Intelektuale</i>	
Dea Nini.....	46
<i>Mbrojtja e të Dhënave Personale. A na Mundëson Kuadri Ligjor Sigurinë e Nevojshme?</i>	
Dea Nini.....	47
<i>Roli i Konventes Europiane të Drejtave të Njeriut në Rendin Juridik Shqiptar</i>	
Dorisa Ruda.....	48
<i>Zhvillime të së Drejtës së Mjedisit në Vështrim Krahasues, Bashkimi European dhe në Shqipëri</i>	
Elba Arapi.....	49
<i>Vendimet e Pushimit në Fazën e Hetimve Paraprake. Standarte të Arritura dhe Probleme të Rezultuara nga Praktika. Kuadri Kushtetues dhe Nderkombëtar</i>	
Eni Grykshi.....	50
<i>E Drejta për të Jetuar në Lidhje me të Miturin</i>	
Enea Basho, Paula Kapaj.....	51
<i>Efektet Vazhdues të Dhunës në Familje Midis Ish-Bashkëshortëve.</i>	
Zalika Gjomemetaj, Olsandra Alinikaj.....	52
<i>Firmat Piramidale në Shqipëri dhe Qëndrimi i Fondit Monetar Ndërkombëtar</i>	
Azis Jata.....	52
<i>Ndryshimet Mes Kishës Protestante Luterane dhe Kishës Katolike</i>	
Bertina Salliu.....	53
<i>Migrimi dhe Efektet Ekonomike, Rasti i Shqipërisë</i>	
Dashnor Kllogjri.....	54
<i>Gjurmime Arkeologjike në Zonën e Përroit të Kushës në Rrethinat e Elbasanit</i>	
Elvis Sllami.....	55
<i>Tiparet e Migrimit Aktual në Shqipëri</i>	
Erind Drita, Fatjon Bebja, Ndue Prela.....	56

<i>Kërkime Arkeologjike në Zonën e Bishqemit, Rrethi i Peqinit</i>	
Ervis Kas.....	57
<i>Fan Nolisipas Historiografisë Shqiptare të Periudhës së Komunizmit</i>	
Kosovar Alija, Artan Reshani.....	58
<i>Kërkime Arkeologjike në Zonën e Funarit, Rrethi i Elbasanit</i>	
Miklevan Deliu.....	59
<i>Takimi i J. B. Titos me Delegacionin Shqiptar në Beograd, 4 Prill 1945</i>	
Shefqet Dinaj.....	60
<i>Katalogimi Informatik në Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore</i>	
Aida Bojdani.....	60
<i>Edukimi Special në Kosovë</i>	
Miranda Lushaj.....	61
<i>Motive Sociale të Duhanprijës-Fenomen Social i Shoqërisë Njerëzore</i>	
Tan Kazazi.....	62
<i>Rëndësia e Përfshirjes së Fëmijëve me Nevoja Të Veçanta Në Sistemin Arsimor</i>	
Vituri Meta.....	62
<i>Organizimi i Kopshteve dhe Shkollave Fillore në Qytetin e Vlorës për Gjithpërfshirjen e Fëmijëve Autikë</i>	
Alma Gusho.....	63
<i>Mësimi i Bazuar në Projekte PBL (Project Based Learning)</i>	
Erviola Konomi.....	64
<i>Marrëdhënia Midis Orientimit të Qëllimit, Strategjive të të Nxënës Vetërregullues dhe Bindjeve Motivuese në Lëndën e Matematikës tek Adoleshentët</i>	
Artë Dulaj.....	65
<i>Ese mbi Krizën në Maqedoni</i>	
Migena Kashta.....	66
<i>Ese mbi Realitetet në Ballkan</i>	
Joana Sinovarfaq	66
<i>Metaphysics in Emily Dickinson</i>	
Ilna Pashaj.....	67
<i>Birësimi, Humanitet apo Kriminalitet</i>	
Emanuel Papa, Kesion Malaj.....	67
<i>Bizneset Ndërkombëtare</i>	
Bleona Hoxha.....	68
<i>Shërbimet e Mikrofinancës në Shqipëri; Studim në Zonat Rurale të Fierit dhe Vlorës</i>	
Emanuel Pone.....	69

<i>Planifikimi Financiar i Familjeve në Shqipëri: Studim në Qytetin e Fierit</i>	
Xhensila Xhaferaj (Pone).....	70
<i>City Toilet</i>	
Adelisa Madani, Kejda Beqiri.....	71
<i>Hologramet dhe Ndihmesa e Tyre në Mesimdhenie</i>	
Hilari Rapushi.....	72
<i>Toponimia e Fshatit Dukat</i>	
Rajmonda Kashuri.....	72
<i>Mixed Reality Technology Breakthroughs</i>	
Denis B. Sinanaj.....	73
<i>A Duhet të Birësohen Fëmijë nga Çiftet Homoseksuale?</i>	
Lavdie Maraj, Sabina Shaqiri.....	74

SËMUNDJET TUMORALE MË TË PËRHAPURA NË QYTETIN E VLORËS

Joana Rjepaj

Departamenti i Biologjisë
Fakulteti i Shkencave Teknike
Universiteti Ismail Qemali Vlorë
joanarj-95@hotmail.com

Abstrakt

Kanceri mund të përshkruhet si një sëmundje në të cilën grupet e qelizave abnormale rriten në mënyrë të pakontrolluar duke injoruar rregullat normale të ndarjes së qelizave. Qelizat normale i nënshtrohen vazhdimisht sinjaleve që diktojnë nëse qeliza duhet të ndahet, diferencuar në një qelizë tjetër ose të vdes. Tumoret më të përhapura në zonën e Vlorës janë disa lloje, më të zakonshmet janë: kanceri i gjirit dhe kanceri i prostatës, ku predispozita më e madhe për të prekurit është mosha 30-60 deri në 63% dhe 61-83 rreth 37% . Qëllimi kryesor i këtij studimi është të informojë dhe të tregojë llojet më të zakonshme të sëmundjeve kancerogjene në popullatë. Puna dhe realizimi i këtij studimi bëhet për një periudhë dyvjeçare (2016-2017). Të dhënat janë marrë në arkivat e Spitalit të Vlorës, ku këto të dhëna tregojnë numrin e pacientëve të diagnostikuar me sëmundje kancerogjene. Në studim kemi vërejtur 75 raste kanceroze të raportuara, 48 prej tyre janë femra dhe 27 janë meshkuj. Llojet më të zakonshme të këtyre sëmundjeve janë: kanceri i gjirit, kanceri i prostatës, kanceri ovarian, kanceri i zorrës së trashë. Grupmosha 50-60 vjeç është më predispozuar se moshat e tjera. Metodot e përdorura për këtë projekt janë të dhënat e mbledhura në arkivat e Spitalit të Vlorës. Këto të dhëna erdhën si rezultat i vizitave në Spitalin Rajonal të Vlorës. Në këtë hulumtim është zbuluar se më shumë se 60% e grave të vizituara kanë më shumë gjasa të vuajnë nga sëmundjet kancerogjene sesa meshkujt. Studimi do të trajtojë qëllimet kryesore të rritjes së kuptimit tonë mbi historinë natyrore të sëmundjeve të kancerit dhe përcaktimin e ndikimit e ndërhyrjeve të mundshme të kontrollit të kancerit me qëllimin përfundimtar të përmirësimit e të sëmurëve me kancer.

Fjalët kyce: Sëmundjet kancerogjene, pacient, kanceri i gjirit, kanceri i prostatës, kanceri i ovareve, kanceri i kolonit

EFIKASITETI I ORËS SË MËSIMIT NËPËRMJET PËRDORIMIT TË MJETEVE OBJEKTEVE DHE PROCEDURAVE SHKENCORE

Anxhela Hazizi

Xhejni Leskaj

Bledar Pepa

Departamenti i Biologjisë

Fakulteti i Shkencave Teknike

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

anxhela.hazizi94@gmail.com

Abstrakt

Në ditët e sotme kërkohet që nxënësit të jenë aktivë në procesin e ndërtimit të njohurive, zbatimit si dhe vlerësimit të tyre. Vetëm në këtë mënyrë njohuritë, shkathtësitë, vlerat dhe qëndrimet do të organizohen në struktura që mundësojnë përdorimin e tyre. Arsimi i mesëm i ulët kohët e fundit është duke pësuar ndryshime në metodikën e mësimdhënies. Në këtë studim të ndërmarrë në kuadër të zhvillimit të temës së masterit profesional në lëndën e biologjisë synohet të tregohet efikasiteti i një orë mësimore duke përdorur mjete e objekte të ndryshme ndihmëse didaktike. Studimi është realizuar në shkollën "7 Dëshmorët" Fier dhe "Jani Minga" Vlorë në periudhën Nëntor, 2017. Gjatë studimit u anketuan 200 nxënës të grupmoshave 10-15 vjeç. Nga analizimi i rezultateve të nxënësve u arrit në përfundimin se mjetet dhe objektet e përdorura në orën e mësimi të biologjisë rriste efikasitetin e ores së mësimi në një masë të konsiderueshme duke i bërë ata më të vëmëndshëm dhe procesin e mësimnxënies më praktik.

Fjalët kyçe: Efikasitet, mësimdhënie, mjete, metoda, biologji, mësimnxënie

ANXIETY IN BREAST CANCER, HOW WELL INFORMED ARE WOMEN

Anxhela Jahaj

Juela Dahri

Ina Nasto

Department of Biology

Faculty of Technical Science

University Ismail Qemali

Vlora, Albania

jahaj_anxhela@yahoo.com

Abstract

Cancer is a disease where abnormal cells divide without control and are able to attack other tissues. Most of the patients and their families face some degree of depression, anxiety, and fear when cancer

becomes a part of their lives. Breast cancer is one of the most diffused tumor in women in the 45-50 year old age and for the most part it is curable if diagnosed in time. Often in cases of such prognosis, patients feel helpless and eager to find ways to get rid of it. The study focuses on anxiety among breast cancer patients and people of different age groups who have previously had family members. It aims at investigating cancer, its symptoms, and the effects of the disease on the anxiety level of patients. In addition, the paper aims at assessing the level of knowledge of women of different age groups, on breast cancer.

Key words:Anxiety, breast cancer, effect of anxiety, symptoms of anxiety.

PËRQËNDRIMI I MAGNEZIT NË SERUM DHE ERITROCIT NË PACIENTËT ME HIPERTENSION ARTERIAL

Bruna Musaj

Udhëheqësi Shkencor: Dr.Sh. Stelijanbuzo

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave Natyrore

Departamenti i Biologjisë

brunamusaj@hotmail.com

Abstrakt

Elektrolitët janë të rëndësishëm për rregullimin e disa proceseve thelbësore në organizmin e njeriut. Magnezi bën pjesë në grupin e kationeve më të rëndësishëm të organizmit. Me anë të studimit tonë kemi vënë në dukje veprime biokimike dhe fiziologjike shumë të rëndësishme të magnezit. Ky studim u krye në 30 pacientë me hipertension arterial. Përcaktimi i magnezit në serumin e gjakut të pacientëve me hipertension arterial u realizua me anë të metodës End-Point (kolorimetrike). Në këtë metodë analitike, jonet magnez të pranishëm në materialin biologjik, hyjnë në reaksion me kromogjenin calmagit, me të cilin në mjedis alkalik japin një kompleks të ngjyrosur. Në mënyrë të ngjashme si për magnezin në serum, u përcaktua dhe përqëndrimi i magnezit në paketën e eritrociteve. Si material biologjik ka shërbyer serum i gjakut. Në përfundim të studimit rezultoi se përqëndrimi i magnezit në serumin e gjakut të pacientëve, që vuajnë nga hipertensioni arterial si dhe përqëndrimi i magnezit brenda eritrociteve është i ulët në krahasim me intervalin e vlerave normale të magnezit në serum dhe magnezit në eritrocite. Ulja e përqëndrimit të magnezit në gjak shkakton hipertension arterial. Në mjaft raste ky hipertension arterial është rezistent ndaj terapisë klasike dhe mjekimi i tij mund të ndihmohet duke dhënë preparate magnezi. Ekzaminimet laboratorike, të cilat kryhen në një kampion gjaku, kërkohen nga klinicisti si për të ndihmuar në vendosjen e një diagnoze sa më të qartë dhe të saktë, ashtu dhe për të ndjekur ecurinë e pacientit. Për të pasur një ecuri dhe mundësi gabimi sa më të vogël, duhet të kihen parasysh një seri me faktorë, të cilët mund të ndikojnë në ekzaminimin e

kërkuar. Kështu duhet marr në konsideratë moshën. Si përfundim themi se elektrolitët ndërhyjnë në mjaft procese jetike të organizmit. Kështu që rregullimi i niveleve të magneziumit në serum dhe në eritrocite ndikon për një mjekim më të suksesshëm të hipertensionit arterial.

Fjalëkyçe: Hipertension, End-Point, xylidyl blue, calmagite, serum, interval tëvleravenormale.

RËNDËSIA ORNITOLOGJIKE E KRIPORES SË NARTËS (VLORË)

Endora Çelohoxhaj

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Biologji Mjedisore

ecelohoxhaj@gmail.com

Abstrakt

Qëllimi i studimit: Qëllimi kryesor është të studiohet dinamika e popullatave të shpendëve ujorë dimërues dhe veronjës në kriporen e Nartës dhe të nxirren në pah faktorët që ndikojnë në të.

Disa kilometra nga qyteti i Vlorës, kriporja e Nartës është një nga zonat më të rëndësishme të Shqipërisë me një biodiversitet mahnitës dhe një nga zonat më të favorshme për shpendët dimërues dhe veronjës të ujit. Ka të dhëna të shumta lidhur me shpendët dimërues të ujit në kriporen e Nartës, por të dhëna të pakta për shpendët riprodhues për të cilët ajo shërben si një zonë e "nxehetë". Qëllimi i kësaj pune kërkimore është vlerësimi në mënyrë të vazhdueshme i dinamikës së popullatave të shpendëve dimërues dhe veronjës, për të nxjerrë në pah rëndësinë ornitologjike të kripores së Nartës, në krahasim me pjesën tjetër të lagunës. Puna kërkimore u krye në periudhën 2016-2017 gjatë muajve të dimrit dhe verës. Të dhënat u studiuan, analizuan dhe u nxorrën përfundime të vlefshme për rëndësinë e kripores për shpendët e ujit.

Në kriporen e Nartës ndodhen 84 lloje, të ndara në 18 familje dhe 9 rende. Familjet me një numër më të madh të llojeve janë familjet Scolopacidae, Anatidae dhe Laridae. Gjatë periudhës së dimrit vumë re 18 lloje shpendësh dimërues, me një total prej 6680 individë (rreth 2/3 e lagunës së Nartës). Për tre lloje folezues zona e Nartës është vendi më i rëndësishëm në Shqipëri. Rendi me numrin më të madh të llojeve riprodhuese është Charadriiformes. Shpendët resident janë një grup mjaft i rëndësishëm, të cilët dëshmojnë për kapacitetin e kripores së Nartës për të siguruar kushtet e favorshme, për mbajtjen e një numri të konsiderueshëm të shpendëve ujorë përgjatë gjithë vitit.

Kërcënimet dhe faktorët që sjellin impakte mjaft të mëdha në dinamikën e shpendëve dimërues dhe veronjës, sidomos në suksesin e riprodhimit të llojeve riprodhuese, janë përshkruar. Bazuar në të gjitha rezultatet tona, kemi dhënë rekomandime të mundshme lidhur me mënyrën menaxhuese të një

habitati mjaft të rëndësishëm siç është kriporja, si dhe me mënyrat e ruajtjes së popullatave të shpendëve të ujit.

Fjalë kyçe: Kriporja e Nartës, Shpend dimëruës, Shpend veronjës, Shpend rezident, Faktorë kërcënues.

TË DHËNAT EKOLOGJIKE DHE SISTEMATIKE TË PESHQVE TË LUMIT TË VJOSËS

Geolind Çobaj

Bledar Pepa

Departamenti i Biologjisë

Fakulteti i Shkencave Teknike

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

geolindcobaj@outlook.com

Abstrakt

Vjosa është një lumë i pasur nga ana ekologjike, ajo rrjedh e pandërprerë që nga burimi e deri në grykëderdhje. Ujërat e sajë janë habitati i shumë lloje peshqish. Qëllimi i këtij studimi ishte njohja dhe studimi i llojeve të peshqve me frekuencë më të lartë që gjenden në lumin Vjosë. Ky studim u realizua në periudhën kohore Maj-Gusht 2017 në rrjedhën e poshtme të këtij lumi. Zona e studimit u nda në 4 stacione. Monitorimi i tyre u krye çdo 14 ditë. Për realizimin e këtij studimi llojet u vëzhguan në mënyrë të drejtpërdrejtë në habitatin e tyre. Duke përdorur mjete të tilla peshkimi si grepi, u kapën lloje të ndryshëm peshqish. Në total u kapën 142 individ të cilët u përkisnin llojeve *B. peloponnesius*, *A. anguila*, *C. nasus*, *S. cephalus*, *D. labrax*, *C. carpio*, *M. cephalus*, *A. alburnus*, *S. trutta*. Lloji më prezentë, me 40 individ rezultoj të ishte *B. Peloponnesius*. Stacioni i parë rezultoi të kishte lloje me frekuencë më të lartë, kundrejt stacioneve të tjera, në të u kapën 51 individ. Rekomandoj që të kryhen studime të mëtejshme në të gjithë gjatësinë e lumit Vjosë që ndodhet në territorin Shqiptarë për të pasur një njohje të plotë të të gjithë habitatit të Vjosës.

Fjalët kyçe: Lumi Vjosë, Peshq, Habitat, *B. peloponnesius*

INFEKSIONET E TRAKTIT URINAR

Klea Bombaj

Departamenti i Biologjisë
Fakulteti i Shkencave Teknike
Universiteti Ismail Qemali ,Vlorë.
kleabombaj197@gmail.com

Abstrakt

Infeksioni i traktit urinar fillon në rrugët tona urinare, të cilat përbëhen nga veshkat uretere, fshikëza e urinës dhe nga uretra. Personat më të predispozuar ndaj këtij infeksioni, janë ata individ që paraprkisht janë të sëmurë me një sëmundje tjetër. Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i treguesve fizikokimik të urinës. Studimi përfshin perjudhën 2 javore në muajin Nëntor. Në Poliklinikën e Vorës janë marrë në shqyrtim 55 analiza urine. Nga të cilat 34 femra dhe 21 meshkuj, 30 pacient nga qyteti dhe 25 pacient nga fshati. Në mostrat e tyre urinare janë vërejtur infeksione të ndryshme. Nga rezultatet e grafikëve vihet re se moshë më e prekur tek femrat ishte 55-70 vjeç, ndërsa tek meshkujt 55-80 vjeç. Femrat janë më të predispozura të preken nga infeksionet urinare sesa meshkujt, duke qenë se uretra e tyre është më e shkurtë dhe më afër anusit. Mosinformimi dhe neglizhimi i simptomave paraprake që shfaqin infeksionet urinare bëjnë këtë infeksion edhe më të komplikuar. Të gjithë individët duhet të jenë më të kujdesshëm dhe sistematik ndaj bërjes së analizave, sepse në këtë mënyrë mund ti parandalojmë ato.

Fjalët kyçe: ITU, uretra ,leukocite eritrocite, mikrooxalate

PËRVIJIME TË FLORËS E BIMËSISË NË GADISHULLIN E PORTO PALERMOS (HIMARË).

Klea Duro

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Shkencave të Natyrës
klea.duro@fshnstudent.info

Abstrakt

Qëllimi i punimit: Të japë disa përvijime të përgjithshme mbi pasurinë floristike dhe habitatet në gadishullin e Porto Palermos (Himarë), si dhe gjendjen e ruajtjes së tyre.

Gjiri i Porto Palermos, i pozicionuar disa kilometra në jug të Himarës, është një nga gjiret më të vegjël të vendit tonë, por që fsheh brenda tij një pasuri të madhe. Për shkak të izolimit për një kohë të gjatë (periudha e diktaturës), ky gji paraqet sot një interes të madh si për turistët, ashtu dhe për studiuesit.

Mjaft interesant për këtë gji është dhe Gadishulli i Porto Palermos, i cili është edhe fokusi i këtij studimi. Ky studim ka si qëllim të japë disa përvijime të përgjithshme mbi pasurinë floristike dhe habitatet në gadishullin e Porto Palermos (Himarë), si dhe gjendjen e ruajtjes së tyre.

Studimi i bimësisë në këtë gadishull është realizuar duke u mbështetur në metodën Braun-Blanquet, e cila bazohet në kryerjen e rlevimeve fitosociologjike në terren. Konkretisht, për këtë studim janë rregjistruar 9 rlevime, të kryera gjatë muajve prill, korrik, kur gjendja e bimëve ka qënë e mirë. Ndërkohë, janë kryer edhe një sërë rlevimesh të tjera, në muaj të ndryshëm përgjatë periudhës 2016 - 2017. Këto rlevime nuk janë rregjistruar për shkak të gjendjes jo të mirë të bimëve, nëkohën kur këto rlevime janë kryer, por normalisht që kanë patur vlerën e tyre në njohjen fizionomisë së bimësisë.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara në terren, mësojmë se flora e gadishullit të Porto Palermos përbëhet nga 182 specie, që u përkasin 160 gjinive dhe 53 familjeve.

Në gadishull ndeshen tre tipe habitatesh: gadishulli, shkëmbinjtë bregdetarë dhe kalaja. Secili tip habitati përfaqësohet nga një bimësi specifike, e cila pavarësisht aktivitetit të shtuar të njeriut në zonë, në përgjithësi ruhet në gjendje relativisht të mirë.

Fusha e studimit: Biologji Mjedisi

Fjalët kyçe: Porto Palermo, Flora, Bimësia, Fitosociologjia, Kalaja, Gadishulli.

IMPAKTI QË JAPIN RRJETET SOCIALE NË PROCESIN E MËSIMNXËNIES DHE NË JETËN E NXËNËSVE TË GRUPMOSHAVE 12-16 VJEÇ

Laureta Sadikllari

Amarilda Rapaj

Ilva Alushi

Departamenti i Biologjisë

Fakulteti i Shkencave Teknike

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

lauretasadikllari@gmail.com

Abstrakt

Shoqëritë njerëzore dita ditës po evoluojnë dhe rrjetet sociale pak nga pak janë kthyer në trendin e kësaj epoke. Të rinjtë janë të parët që i përqafojnë këto ndryshime dhe që provojnë efektet e tyre. Ky studim ka si synim të tregojë impaktin që ka përdorimi i rrjeteve sociale në procesin e mësimnxënies dhe në jetën e nxënësve. Studimi është realizuar në shkollën "ELITE" të qytetit të Vlorës dhe shkollën "Andon Xoxa" të qytetit të Fierit, nëpërmjet një pyetësori. Nën studim janë marrë 264 nxënës të grupmoshave 12-16 vjeç dhe nga analiza e të dhënave u arrit në përfundimin se koha të cilën nxënësit shpenzojnë në rrjetet sociale është shumë herë më e madhe se koha që ata shpenzojnë për të mësuar. Interpretuar nga rezultatet tona, duke qënë se me rritjen e moshës së fëmijëve ulet kujdesi i prindërve

ndaj aktiviteteve që ata kryejnë në këto rrjete, fëmijët janë më vulnerabël ndaj kërcënimeve. Mbështetur edhe nga vlerësimi i të dhënave tona ku, mosha më e hershme e fillimit të përdorimit të rrjeteve sociale është 9 vjeç, ndonëse 62.8 % e nxënësve janë koshient për rrezikshmërinë që i kanoset.

Fjalë kyçe: rrjete sociale, mësimnxënie, sjellje, rrezikshmëri.

HARTËZIMI ISHPËRNDARJES SË GROPAVE SEPTIKE, MBETURINAVE URBANE DHE INERTE, PËRGJATË VIJËS BREGDETARE DHËRMI- HIMARË

Lorela Pashaj

Ferdinant Ismailaj

Ilva Alushi

Departamenti i Biologjisë

Fakulteti i shkencave teknike

Universiteti "Ismail Qemali"

Vlorë, Shqipëri.

lorela.pashaj@yahoo.com

Abstrakti

Mbetjet urbane dhe inerte mbeten një problem serioz dhe si të tilla duhet të menaxhohen në mënyrën e duhur. Prodhimi i mbetjeve rritet me rritjen e popullsisë dhe zhvillimin ekonomik. Një menaxhim jo i duhur i mbetjeve urbane dhe inerte përbën një rrezik si për shëndetin e njerëzve ashtu edhe për mjedisin, por njëkohësisht ndikon negativisht në zhvillimin e turizmit në vend.

Studimi ka për qëllim krijimin e një harte për të identifikuar zonat me potenciale më të larta për ndotjepërgjatë vijës bregdetare Dhërmi – Himarë (e karakterizuar nga një numër i lartë turistësh), duke evidentuar kështu zonat me kanalizime dhe ato që posedojnë alternative tjetër (si gropa septike). Në total janë kontrolluar në terren 30 subjekte që kryejnë aktivitetin e tyre në Dhërmi, dhe 48 në Himarë, Qarku Vlorë. Duke i hartëzuar këto hotspote, ne lehtësojmë në të njëjtën kohë dhe marrjen e masave nga institucionet kompetente, për të minimizuar efektet negative që krijohen në mjedis, dhe me pas indirekt në shëndetin tonë.

Fjalët Kyçe: Mbetjet urbane, Mbetjet inerte, Gropa septike, Hartëzim, Menaxhim mjedisi.

SOME PRELIMINARY DATA FOR THE EVALUATION OF WATERS QUALITY IN NARTA AND ORIKUM LAGOONS USING FROGS AS BIOINDICATORS, VLORA, ALBANIA

Natasha Aliu

Arta Lugaj

Blerta Laze

Department of Biology

University of Vlora "Ismail Qemali"

tashakurti@hotmail.com

lugajarta@gmail.com

Abstract

Bioindicators are organisms of species highly sensitive to the changes in the environment, which can provide information about the health of the ecosystem. The aim of this study was to use the blood parameters as non-lethal biomarkers in the effects of pollution. We analyzed 150 individuals of the species *Rana balcanica* and *Rana europea* collected in three sampling areas, near the Narta and Orikum lagoons and in a reference area named as Marmiroi fount in 2015. To assess the level of contamination, we evaluate the erythron profile. The presence of Genotoxic effects of pollution in the environment, was assessed by determining the frequency of micronucleus. It was noted that the frequent anomalies expressed in % (destroyed red blood cells, immature red blood cells, degenerated and divided) were higher in areas near the lagoon of Narta and Orikum compared with the reference area. The presence of micronucleus and red blood cells with the vacuolized cytoplasmas as an indicator of genotoxic damage levels were lower in Narta, Orikum and in reference areas. In conclusion, we can say that morphological changes of erythrocytes (erythron profile) and the frequency of micronucleus are non-lethal biomarkers, suitable for monitoring the effects of environmental pollution to amphibians.

Field study: Environmental Biology

Keywords: Bioindicators, *Rana balcanica*, Ecosystem, Biomarker, Erythron profile.

PRELIMINARY DATA ON THE PRESENCE OF CYBERBULLYING IN SEVERAL SCHOOLS IN VLORA, ALBANIA

Ujeza Fejzaj

Enxhi Lulaj

Ina Nasto

Department of Biology

Faculty of Technical Science

University Ismail Qemali

Vlora, Albania

ujezafejzaj@yahoo.com

Abstract

There are many different ways in which cyberbullies reach their victims, including instant messaging over the Internet, social networking sites, text messaging and phone calls to cell phones. The new technologies that have grown in popularity over the past decade have enabled classroom bullying to go out of the classroom and into students home lives. This paper explores how cyber bullying has become a serious problem in schools of all levels. There have been numerous stories recently in the media that demonstrate the serious repercussions of cyber bullying. It has recently been a hot topic in the media, and there has been much talk about the best way for parents and teachers to handle such matters. This paper investigates the ways cyber bullying is occurring, whom it is happening to, and what can / is being done about it. This paper seeks to find the main causes of this phenomenon in children of different ages in the schools of Albania.

Key words: cyberbullying, technology, school, education, social networks, bullying

ROLI I LOGOPEDËVE NË LIDHJE ME TERAPINË DHE REHABILITIMIN E SËMUNDJEVE NEURODEGJENERATIVE

Msc.student Maria Ramaj

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Fakulteti I Shkencave Mjekësore Teknike

maria.ramaj1@gmail.com

Abstrakt

Ky punim shqyrtoi rolet e patologëve të gjuhës (SLPs) brenda terapisë dhe rehabilitimit të sëmundjeve neurodegenerative. Studimi u realizua duke u bazuar në rishikimin e literaturës për të shpjeguar patologjite neurologjike dhe rolet e SLP-ve në trajtimin e pacientëve që vuajnë nga këto sëmundje. Punimi gjithashtu ka studiuar gatishmërinë e logopedëve të certifikuar, nivelin e SLP-ve

për të punuar me pacientët neurologjik, si dhe njohjen për rolet dhe përgjegjshmërinë e tyre në terapinë , rehabilitimin, dhe ndërgjegjësimin për format e mundshme të trajtimit të këtyre patologjive. Studimi u realizua brenda territorit të Shqipërisë nëpërmjet një pyetësori elektronik, i cili u dërgua në 40 logopedë të certifikuar në të gjithë Shqipërinë. Përgjigjet e anketës treguan se SLP-të ndihen të pa përgatitur për të marrë pjesë në rehabilitimin e sëmundjeve neurologjike menjëherë pas marrjes së diplomës, por, njihen me shumicën e roleve dhe përgjegjësi të SLP-ve. Shumica e logopedeve të anketuar ishin të vetëdijshëm për gamën e gjerë të programeve të trajtimit në dispozicion për pacientët me këto patologji.

Fjalet kyce: Logoped; Sëmundje neurodegenerative, Terapi, Rehabilitim

ROLI JONË SI INFERMIER NË FENOMENIN E BULLIZMIT NË SHKOLLË DHE SHOQERI

Elira Lamce

Fakulteti I Shendetit Publik

Universiteti Ismail Qemali

Vlore

eliralamce@gmail.com

Abstrakt

Hyrje: Termi Bulizem nënkupton sjellje që imponojnë qendrim të caktuara nëpërmjet përdorimit të forcës apo abuzimi që praktikon një grup i shoqërisë për të frikësuar një target grup të caktuar. Ekzistojnë mënyra të ndryshme për shfaqjen e këtij fenomeni, si dhuna fizike apo psikologjike. Arsyet që bulizmi ekziston si fenomen janë nga më të shumtat por padyshim që edukimi dhe paragjykimi qëndrojnë në krye të listës.

Qellimi: Evidentimi i rolit pozitiv i infermierit në uljen e rasteve të prekura , dhe permiresimin e gjendjes shëndetësore nga fenomeni i Bullizmit nëpërmjet anketimit , analizimit dhe vezhgimit të detajuar në një periudhë 6-mujore në disa shkolla 9-vjecare të Vlorës. U evidentua se femijet në shkollat e Vlorës janë viktima të Bullizmit në 70% të rasteve dhe 30% e tyre janë ushtrues të rregullt të bulizmit ndër vite.

Metodologjia: Ky është një studim evidentues dhe krahasues, ku nxjerr në pah dukurine në rritje të fenomenit të Bullizmit , ku të dhenat janë siguruar nëpërmjet anketimit , analizimit dhe vezgjimit të detajuar në periudhen Janar-Qershor 2017

Rezultatet: Fenomeni I Bullizmit avancon drejt zhvillimit me shpejtesi. Grupmoshat me te prekura jane ato 7-15 vjec. Në rreth 70% të rasteve evidentohen viktima të Bullizmit dhe 30% të tyre ushtrues të rregullt të Bullizmit. Identifikimi i rasteve me trauma psikologjike e deri tek ajo fizike me gervishtje, shenja në trupe, të nxira, dhunë, e deri tek përdorimi i mjeteve të ftohta, përbën një tregues të qarte të bulizmit një gjendje emergjente. Rezultatet e studimit theksojne rolin thelbesore të

infirmierit në permiresimin multimedial dhe trajtimin e vazhdueshem të gjendjes së pacienteve përmes edukimit dhe trajtimit shëndetësor dhe social në parandalimin e Bullizmit, duke ndikuar kështu në rritjen e cilësisë së jetës dhe edukimit.

Fjalë kyçe: Bullizmi , infirmieri , trajtim multimedial, paaftësi, nivel i ulët i etikës kulturore.

SHËNDETËSIA FALAS

Emerlinda Lame

Fjorentin Harizi

Florin Ibrahim

Nustil Ali

emerlinda8@gmail.com

Fakulteti i Shëndetit Publik

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Abstrakt

Shëndetësia falas është tërësia e institucioneve ku shërbimi shëndetësor ofron akses cilësor 24orë në ditë dhe paguhet nga shteti për të gjithë sektorin shëndetësor publik. Ndër prioritetet qeveritare të 2014 për shëndetësinë falas citojmë: "Shërbimet shëndetësore ofrohen falas; Qëndrat ambulatorë ofrojnë shërbim aktiv 24 orësh dhe falas; Gjithçka kryhet Brenda sektorit të shëndetësisë publike pa u drejtuar te private". Qëllimi i studimit deskriptiv ishte vlerësimi i ofrimit dhe përfitimit nga popullata e shëndetësisë falas në qytetin e Vlorës. Ky studim u realizua në popullatën e qytetit të Vlorës në Nëntor 2017. Të dhënat u mbledhën me anën e një pyetësi të vetë-administruar me 6 pyetje. U plotësuan në total 100 pyetësorë nga kalimtar të rastësishëm. 15% e të intervistuarve pohojnë se kryhet gjithçka nga sektori shëndetësor publike pa u drejtuar tek privati, 65% Jo, 20% Pjesërisht. Nëse rimbursohen mbi 40-50% e ilaçeve nga shteti pjesëmarrësit referojnë -13%~Po; 57%~Jo; 30%~Pjesërisht. Nëse ekziston korrupsioni/ryshfeti në shëndetësinë falas, pjesëmarrësit në studim referojnë -45%~Po;23%~Jo;32%~Pjesërisht. A ofrohet shërbim aktiv 24 orësh në qendrat ambulatorë;-35,4%~Po;29,6%~Jo;35%~Pjesërisht. Të kënaqur me shërbimin e ofruar rezultojnë-33,6%~Po; 40,4%~Jo;30%~Pjesërisht.

Sipas vlerësimit nga popullata qytetare, prioritetet qeveritare për shëndetësinë falas nuk përmbushen, pasi prioritet me % më të lartë zënë përgjigjet negative, ndërkohë që përqindja më e lartë e të intervistuarve drejtohen për shërbim shëndetësor tek privati.

Fjalë kyçe:Shëndetësia falas, shërbim shëndetësor,përfitim falas,sektoret shëndetësor.

ROLI I INFERMIERIT NË VETË-MENAXHIMIN E DIABETIT TIPI 2: RISHIKIM LITERATURE

^{1*} Jonida Çeloaliaj,

² Velide Pulomemoj,

³ Fatjona Kamberi

^{1,2} Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" Vlorë

³ Qendra Studimore për Shëndetin Publik

^{1*} Jonaceloaliaj@hotmail.com; velopulomemoj@gmail.com

Abstrakt

Aftësitë e vetë-menaxhimit janë pjesë thelbësore e kujdesit të sëmundja të diabetit të tipit 2. Ndiham dhe mbështetja e stafit infermior janë vendimtare në këtë proces jo vetëm për të siguruar pacientit kujdes cilësor por edhe për parandalimin e komplikacioneve. Qëllimi i studimit ishte rishikimi i literaturës në lidhje me rolin e infermierit në vetë-menaxhimin e diabetit të tipit 2. Kërkimi përfshiu të dhënat bazë elektronike të PubMed Central. Kriteret e përfshirjes ishin artikuj me tematikën e interesit, të publikura në anglisht, në pesë vitet e fundit. U identifikuan më shumë se njëzetë artikuj potencial por në analizën përfundimtare u përfshin rezultatet origjinale të katër, studimeve. Rezultatet theksojnë se në sajë të ndihmës së stafit infermior pothuajse në të gjitha studimet u evidentuan përmirësime të dukshme në aftësitë e vetë-menaxhimit të sëmundjes me reflektim direkt në cilësinë e jetës së këtyre pacientëve dhe në koston ekonomike të sëmundjes. Edhe vetë infermierët theksojnë nevojën e trajnimit të tyre për shkak të njohurive të pamjaftueshme që kanë në lidhje me aftësimin e pacientëve me diabet të tipit 2 për vetë-menaxhim të sëmundjes. Pacientët e informuar, bashkëpunues dhe të gatshëm për të bërë ndryshime në stilin e tyre të jetesës mund të përmirësojnë dukshëm rezultatet klinike.

Fusha e studimit: Infermieri, Shëndet Publik

Fjalë kyçe: Diabeti i tipit 2, njohuri, kujdes, aftësim, vetë-menaxhim, infermier.

SIGURIMI I KUJDESIT MË TË MIRË SHËNDETËSOR TË MUNDSHËM PËR PACIENTET BAZUAR NË *PATIENT HEALTH QUESTIONNAIRE (PHQ)*: IMPLIKIME PËR PRAKTIKËN

^{1*} Velide Pulomemoj,

² Jonida Çeloaliaj,

³ Fatjona Kamberi

^{1,2} Fakulteti i Shëndetit Publik, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" Vlorë

³ Qendra Studimore për Shëndetin Publik

¹ velopulomemoj@gmail.com; Jonaceloaliaj@hotmail.com

Abstrakt

Patient Health Questionnaire (PHQ), Pyetëtori i Pacientit për Shëndetin rezulton të jetë instrumenti më efikas që reflekton se pjesa më e madhe e pacientëve me çrregullime depressive ose ankthi që paraqiten në shërbimin shëndetësor parësor paraqesin ankesa somatike. Qëllimi i studimit transversal të kryer në Spitalin Rajonal Vlorë, në Nëntor 2016 ishte vlerësimi i shëndetit të pacientëve si element i rëndësishëm i sigurimit të kujdesit më të mirë shëndetësor të mundshëm. Në studim u përfshinë 43 pacientë të hospitalizuar. Për mbledhjen e të dhënave u përdor pyetëtori PHQ. 67% e pacientëve ishin femra. Mosha mesatare 42.8vjeç, $SD \pm 17.72$, Simptomat fizike më të shpeshta ishin: dhimbje të krahëve, këmbëve, nyjeve, dhimbje gjoksi, frikë për rënie ose përgjumje. 80% (n=32) e pacientëve, 95%IB [64.35-90.95] raportojnë se në 4 javët e fundit kanë pasur kriza ankthi. U evidentua lidhje statistikisht sinjifikante midis simptomave fizike dhe krizave të ankthit, $p < 0.05$. Rezultatet theksojnë se simptomat fizike janë të lidhura ngushtë me ankthin dhe ndjenjën e papritur të frikës dhe panikut. Marrja në konsideratë e këtyre simptomave nga personeli infermior në praktikën klinike, është shumë e rëndësishme për të përcaktuar tendencën për ankth të pacientëve të hospitalizuar, me impakt real në cilësinë e kujdesit të ofruar.

Fusha e studimit: Infermieri, Shëndet Publik

Fjalë kyçe: PHQ-SADS, pacientë të hospitalizuar, kujdes, simptomat fizike, ankthi, implikime, praktikë.

MENAXHIMI I DHIMBJES NË REPARTIN E URGJENCËS

Fjorida Koromani

Eva Muhaj

Fakulteti i Shëndetit Publik

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"

Vlorë

fjoridakoromani4@gmail.com

Abstrakt

Vlerësimi i dhimbjes është një element shumë i rëndësishëm i praktikës infermiore pasi dhimbja është sinjali i parë që e detyron pacientin të kërkojë ndihmë mjekësore. Qëllimi i studimit transversal ishte vlerësimi i menaxhimit të dhimbjes në repartin e urgjencës, Spitali Rajonal Vlorë si dhe identifikimi i nivelit dhe tipit më të shpeshtë të dhimbjes. Mostra e studimit ishin 88 pacientë të zgjedhur rastësisht që u paraqitën në repartin e urgjencës gjatë periudhës që u realizua studimi, Maj 2017. Të dhënat u mblodhën nëpërmjet pyetëtorit MCGILL. Për nivelin e dhimbjes u përdor shkalla numerike nga 0-10. Ndërhyrjet infermiore menaxhuese të dhimbjes u siguruan nga kartela mjekësore dhe observimi gjatë studimit. Mosha mesatare e pacientëve 52.34vjeç, 57.65% ishin femra.

Dhimbjet më të shpeshta ishin të lokalizuara në bark 38.64%, gjoks i majtë 25%, kokë 20.45%. Nivel 9 (më shpesh gratë) dhe 8 (më shpesh burrat) të dhimbjes referojnë respektivisht 18.39% dhe 17.24% e pacientëve. Diagnozat më të shpeshta ishin sëmundje të zemrës 15.12%, kolika abdominale 13.95%, krizë hipertensive/diabet mellitus 11.63%. Medikamentet më të përdorura ishin sulfat magnezi, buskopan, ranitidina, lasiks. Vlerësimi dhe menaxhimi i duhur i dhimbjes nga ana e infermiereve ka një impakt shumë të madh dhe jetësor për pacientin.

Fusha e studimit: Infermieri

Fjalë kyç : Dhimbje, MCGILL, vlerësim i dhimbjes, shkallë numerike e vlerësimit, menaxhim.

VLERËSIMI I STATUSIT NUTRICIONAL DHE RREZIKUT PËR MALNUTRICIONTE PACIENTËT E MOSHUAR TË HOSPITALIZUAR

Suada Golaj

Fakulteti i Shëndetit Publik

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" Vlorë

suadagolaj@gmail.com

Abstrakt

Vlerësimi i Statusit Nutricional (SN) të pacientëve të moshuar nënvlerësohet në mjediset spitalore ndërkohë që studimet tregojnë se malnutricioni është mjaft i përhapur te këta pacientë. Studimi transversal kishte si qëllim vlerësimin e SN të pacientëve të moshuar dhe identifikimin e faktorëve të rrezikut për malnutricion. Mostra e studimit ishin 129 pacientë të Spitalit Rajonal të Vlorës të përzgjedhur rastësisht gjatë periudhës Prill-Maj 2017. Pyetësi Mini Nutritional Assessment (MNA) u përdorur për mbledhjen e të dhënave. Peshja dhe gjatësia u referuan nga pacientët, kurse perimetri abdominal u mat me një metër shirit. Analiza statistikore përfshiu llogaritjen e frekuencave dhe të BMI. Moshja mesatare e pacientëve ishte 68.62 vjeç. 51.94% e mostrës ishin burra. Çrregullimet mbizotëruese ishin diabet/ probleme kardiake respektivisht (20.93%), probleme pulmonare (10,08%). 38.76% e pacientëve (n=50) ishin me SN normal, 38.76% (n=50) ishin në rrezik për malnutricion ndërsa 13.95% (n=18) e pacientëve shfaqën malnutricion. Referuar rezultateve tendenca për malnutricion të pacientëve të moshuar të hospitalizuar është e lartë. Sëmundjet kronike dhe ditëqëndrimi në spital shërbejnë si faktorë rreziku për malnutricion. Vlerësimi nga ana e infermiereve i SN të pacientëve është element i rëndësishëm i kujdesit, me ndikim direkt në cilësinë e kujdesit dhe të jetës së pacientëve të moshuar.

Fusha e studimit: Infermieri

Fjalë kyç: pacientë të moshuar, hospitalizim, SN, MNA, rrezik për malnutricion, kujdes infermior, BMI.

VLERËSIMI I NJOHURIVE DHE QËNDRIMEVE PËR IST, HIV/AIDS TEK STUDENTËT E INFERMIERISË

Elda Shahinaj

Fakulteti i Shëndetit Publik
Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" Vlorë
elda.shahinaj@yahoo.com

Abstrakt

Infeksioni Seksualisht i Transmetueshëm (IST), HIV/ AIDS është shqetësues për shkak se numri i rasteve është rritur në mënyrë dramatike gjatë dhjetë viteve të fundit. Qëllimi i studimit ishte vlerësimi i njohurive dhe qëndrimeve për IST, HIV/AIDS tek studentët e infermierisë, Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali". 337 studentë të Infermierisë u bënë pjesë e studimit duke plotësuar një pyetësor anonim të vetë-administruar. Studentët kishin njohuri të mira në lidhje me HIV si dhe qëndrim pozitiv ndaj njerëzve me AIDS. 43% e tyre besonin se mushkonjat mund të transmetojë HIV/AIDS dhe 27.5% besonin se virusi mund të transmetohet duke ngrënë dhe duke pirë nga e njëjta pjatë ose gotë e një personi me HIV pozitiv. 32.9% janë informuar në lidhje me HIV nëpërmjet revista/gazeta/internet. 23.7% e studenteve nuk kanë informacion në lidhje me testet diagnostikuese të HIV. 16.9% e të gjithë studentëve të infermierisë janë shprehur se SIDA zhvillohet menjëherë sapo personi infektohet me HIV. Raportohet gatishmëri për t'u kujdesur për njerëzit me AIDS. Edukimi i vazhdueshëm i studentëve të infermierisë në planin e trajtimit të sëmundjes jo vetëm në planin biologjik por edhe në atë shpirtëror, social-familjar, psikologjik dhe në kuadër të reduktimit të diskriminimit ndaj AIDS është thelbësor.

Fusha: Infermieri

Fjalët kyçe: IST, HIV, AIDS, njohuritë, qëndrimet, studentët e infermierisë.

GRUPET BASHKËTINGËLLORE NË PEJË ME RRETHINË

Arizona Lajçi

Ermira Mehmeti

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"
arizonalajqi@hotmail.com

Abstrakti

Ky punim synon të vë në dukje disa karakteristika të veçanta që lidhen me grupet ebashkëtingëllorevenëtë folmen e Pejës me rrethinë. Grupet bashkëtingëllore në gjuhën shqipe konsiderohen si tingujtë përbërë, sepse shqiptohen vetëm me një nyjëtim të vetëm të përbërë. Në trajtim do të jenë grupet bashkëtingëllore, të cilat në të folmet e tjera të Kosovës janë reduktuar në

bashkëtingëlloren e parë. Në trajtim do të jenë grupet: mb, , nd, ng. Brenda kësaj teme do të mundohemi t'i japim disa karakteristika kryesore rreth tëfolmes së Pejës me rrethinë, si p.sh:Cila është e folmja e Pejës brenda të folmeve të gegërishtes verilindore? Sa janë ruajtur këto togje të bashkëtingëlloreve në këtë të folme? Si paraqiten ato në Atlasin dialektologjik të gjuhës shqipe etj. E folmja shqipee Pejësot duhet të shihet në këndvështrimin sociolinguistikë, sipas moshës dhe gjinisë. Ajo është një produkt i përzierjes së të folurit tradicionale Pejane me të folmen e rrethinës së qytetit e dominuar nga pjesa jugore dhe lindore. Qendrat urbane sot kanë ndryshuar strukturën e popullatës, ato tashmë janë me heterogjene. Prandaj nisur nga kjo lëvizje natyrisht se kemi edhe trysninë e faktorit shoqëror mbi gjuhën. Këto ndryshime kanë ardhur edhe si rrjedhojë e zhvillimit ekonomik dhe kulturor të këtij qyteti. Peja tashmë është një qytet universitar, kështu prania e studentëve nga vendet e ndryshme ka sjellë lëvizje gjuhësore.

Fusha e studimit: Gjuhë shqipe

Fjalët kyçe: Grupe bashkëtingëllore, e folme, gjuhë, shoqëri, moshë, ADGJSH, qendër urbane etj.

NJËSITË FRAZEOLOGJIKE NË ROMANIN ‘KRONIKË NË GUR’ TË I. KADARESË

Aurora Koçi

Gjuhë-Letërsi

Universiteti ‘Aleksandër Xhuvani’ Elbasan

aurorakoci7@gmail.com

Abstrakt

Objekti i këtij punimi bëhen ato togfjalësha të qëndrueshëm të formuar historikisht, që nga ana e kuptimit kategorial janë ekuivalent me një fjalë të vetme dhe, sikurse fjala, kanë funksion emërtues . Këto togfjalësha përbëjnë frazeologjinë e gjuhës. Frazeologjia është një fushë e gjerë studimi ,që ka objekt të vetin njësitë frazeologjike gjuhësore. Frazeologjia nuk bën vetëm përshkrimin sistematik të njësive frazeologjike te gjuhës sonë, por ndihmon edhe për zotërimin e tyre aktiv, për përvetësimin e normës letrare dhe të shprehive të përdorimit.

Çdo shkrimtar i madh hyn në një marrëdhënie të caktuar me gjuhën e kombit të tij. Kjo marrëdhënie varet nga aftësia për t'i përdorur në mënyrë përzgjedhëse dhe krijuese mjetet gjuhësore. Kjo ka qenë shtysa e parë që më çoi te mendimi për të bërë objekt studimi njësinë frazeologjike në veprën ‘Kronikë në gur’ të Kadaresë,duke u ndalur në klasifikimin sipas kritereve leksiko-gramatikore dhe figurshmërisë. Veprën e Kadaresë e kam trajtuar edhe në aspektin stilistik. Jam përpjekur të shqyrtoj leksikun e figurshëm të veprës,të zbuloj mjetet e veçanta gjuhësore,figurat letrare të cilat formësojnë individualitetin e tij krijues.

Frazeologjia përmban mjete të fuqishme stilistike të cilat e bëjnë ligjërimin të bukur, të figurshëm, bindës. Urtësia popullore, ndjenja e hollë gjuhësore e krijuesit të madh, të mishëruar në këto shprehje të shkurtra, i japin ligjërimin bukuri e larmi të këndshme.

Fjalë kyç: njësi frazeologjike , ligjërim , frazeologjia.

LIDHËZAT NË PERIUDHAT ME SIFJALI PLOTËSORE (KRYEFJALORE, KALLËZUESORE, KUNDRINORE DHE PËRCAKTORE).

Albana Zeka

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan
Fakulteti i Shkencave Humane, Dega Gjuhësi
albanazeka17@gmail.com

Abstrakt

Do të kemi objekt studimi lidhëzat në periudhat me sifjali kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore dhe përcaktore. Të gjitha të përfshira në një emërtim të përbashkët, periudha me sifjali plotësore. Nëpërmjet shembujve të nxjerrë nga libra të ndryshëm dhe çështjeve të trajtuara ne do të zbulojmë tipare dhe përngjasime.

Për të studiuar këto periudha na ka ndihmuar vjelja shteruese në të gjitha stilet, në stilin letrar, publicistik, shkencor, historik dhe juridik. Qëllimi i punimit tonë do të jetë gramatikor. I mbështetur ky në gramatikën tradicionale aq dhe në atë të kohëve të fundit. Jemi mbështetur në literaturën e gjuhëtarëve që kanë studiuar këto periudha dhe sidomos botimin e fundit të prof.dr.Mehmet Çelikut "Sintaksë e gjuhës shqipe"(Pëbërësit sintaksorë).

Në studimin e këtyre periudhave duke marrë shkas lidhëzat por jo vetëm ne do të nxjerrim të veçanta e tyre. Në periudha të tilla a është plotësimi i domosdoshëm dhe si arrihet ai? A kemi një rol të domosdoshëm të foljeve në këto periudha dhe cilat janë ato?

A luajnë një rol të rëndësishëm foljet e fjalisë kryesore, a duhet të flasim për valencë të tyre? A mund të flasim dhe për valencë të emrit dhe cilët emra e mbartin atë? Në këtë punim modest ne do të përpiqemi t' i japim përgjigje këtyre pyetjeve.

Punimin tonë e kemi strukturuar në katër krerë:

- 1-Periudhat lidhëzore në sifjalitë kryefjalore
- 2-Periudhat lidhëzore me sifjali kallëzuesore
- 3-Periudhat lidhëzore me sifjali kundrinore
- 4-Periudhat lidhëzore me sifjali përcaktore.

Përmes një analize sintaksore, semantike le të përpiqemi për arritjen e disa përfundimeve të vlefshme.

Fusha: gjuhësi, sintaksë

Fjalët kyç : lidhëza, sifjali drejtuese, sifjali plotësore, valencë e foljes, valencë e emrit.

NGJYRESAT KRAHINORE NË MJEDISËT SHKOLLORE NË DEÇAN

Rajmonda Dacaj

rajmondadacaj@hotmail.com

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"

Studim i fushës së gjuhësisë

Abstrakt

Hulumtimi i këtij punimi i përket fushës së sociolinguistikës, duke synuar të sjellim ndryshime gjuhësore në raport me shoqërinë dhe duke trajtuar ndikimin e faktorëve sociolinguistikë në shfaqjen e këtyre ndryshimeve. Kundrim i këtij studimi është ligjërimi i disa mësimdhënësve me theks të veçantë, disa ngjyresa krahinore që dalin gjatë këtij procesi. Mbledhja e materialit për të realizuar atë është bërë në mjedis shkollor në Deçan, gjatë zhvillimit të orëve mësimore, duke e ruajtur besnikërinë e hulumtimit subjektet nuk kanë qenë në dijeni për hulumtimin e bërë, prandaj kjo ka sjellë edhe gjendjen e vërtetë të gjuhës shqipe në ato ambiente.

Punimi është realizuar duke nxjerrë vetëm trajtat e dialektore që kemi evidentuar gjatë ligjërimin të subjekteve, të cilat i kemi analizuar në dy rrafsh: në rrafshin fonetik dhe në atë morfologjik, duke i vënë në krahasim me trajtat e standardizuara. Analiza fonetike përfshinë shqyrtimin e fjalëve në sistemin e zanoreve dhe sistemin e bashkëtingëlloreve, grupet e zanoreve dhe grupet e bashkëtingëlloreve si dhe disa dukuri fonetike që kemi hasur. Ndërsa, analiza morfologjike është bërë duke klasifikuar fjalët sipas pjesëve të ligjëratës, duke i parë ato si e bëjnë shumësin, gjininë, rasat, lakimet disa emra, te folja kemi trajtuar mënyrën e tyre, kohët dhe gjendjen e formave të pashtjelluar të foljeve, si dhe gjurmët e trajtave dialektore te disa lloje të ndajfoljeve. Trajtat e nxjerra kanë dëshmuar që e folmja tradicionale nuk zhduket pa lënë gjurmët e saja pavarësisht ngritjes së nivelit të standardit gjuhësor.

Fjalët kyçe: ligjërim, ngjyresë, trajtë e standardizuar, analiza fonetike, etj.

RRETH VEPRËS “DRANJA” TË AUTORIT MARTIN CAMAJ

Alma Stuja

Besarta Dakaj

Alba Macula

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”

stuja.alma@gmail.com

besartadakaj@hotmail.com

albamacula97@gmail.com

Abstrakt

Pasuria dhe mjeshtëria shprehëse në veprën “Dranja” të Martin Camajt ka kushtëzuar që ajo të çmohet si njëra nga veprat më të rëndësishme dhe me komplekse të autorit. Kjo thuhet edhe në një varg punimesh e studimesh që i janë kushtuar asaj.

Në këtë vepër Martin Camaj përmes një simbolike të pasur, të gërshetuar me mitin, vështron botën tonë në rrjedhë të kohëve; shqipton fatin tragjik, pesimet e përjetuara, po dhe qëndresën.

Martini e ndërton rrëfimin përmes një gjuhe poetike sa të pasur aq dhe të veçantë, që i përgjigjet plotësisht parimit të tij krijues: gjërat që rrëfen të mbesin në thellësi.

Është bërë me shumë shkathtësi gërshetimi i simbolikës së breshkës me shenjën e gjarprit në rrashtën e saj, që dashur e pa dashur na fut në botën e pafund mitike.

Vepra “Dranja”, si e kanë thënë edhe studiuesit e saj, është vepra që cilësohet me një sistem të jashtëzakonshëm kuptimor dhe si e tillë mundëson qasje dhe interpretime të ndryshme.

Fjalët kyçe: Martin Camaj, “Dranja”, struktura gjuhësore, mjeshtëria e fjalëve, simboli i breshkës, shpirti shqiptar.

RRETH “ÇETËS SË PROFETËVE” TË PJETËR BOGDANIT

Arbër Malota

Fatjona Gashi

Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”

arbermalota@hotmail.com

fatjona97@outlook.com

Abstrakti

Në këtë punim kemi vështruar njërin nga veprat më të rëndësishme të letërsisë së vjetër shqipe “Çetën e profetëve” të Pjetër Bogdanit të botuar më 1685.

Për hartimin e këtij punimi kemi shfrytëzuar para së gjithash veprën e Bogdanit dhe një varg punimesh dhe studimesh që i janë kushtuar asaj.

Veçanërisht kemi vështruar sistemin e ideve dhe mënyrën e shtjellimit të veprës, pastaj çështjet që lidhen me Biblën dhe literaturën teologjike dhe ndërlidhjen e pjesëve midis tyre dhe mënyrën si e

plotësojnë njëra – tjetrën. Kemi vështruar edhe gjuhën e veprës dhe stilin që përdor autori, që i japin asaj një vlerë më vete.

Fjalët kyçe: Pjetër Bogdani, vlera letrare, ide, letërsi e vjetër etj.

NJË VËSHTRIM MBI FJALËFORMIMIN NË GRAMATIKAT E SHQIPES

Elsa Boshku

Universiteti i Tiranës

Fakulteti Histori-Filologji

Master Shkencor Gjuhësi

elsaboshku@gmail.com

Abstrakt

Objekti i këtij punimi është një vëzhgim i prirjeve të përgjithshme dhe të veçanta tësisht të fjalëformimit duke u mbështetur kryesisht në gramatikat e shqipes që në trajtimete para, deri në arrijtjet e sotme kur synohet një mëvetësi e fjalëformimit si disiplinë e veçantë.

Një vështrim mbi përkufizimet e ndryshme të fjalës, të analizës së saj strukturore e morfematike, na lejon të arsyetojmë e të kuptojmë drejt qëndrime të ndryshme që janë mbajtur rreth disa problematikave, siç janë klasifikimetjo të njënjtësuarapër mënyrave të fjalëformimit, terminologjinëapo përfshirjen e kësaj fushe në dy disiplina, përkatësisht leksikologji e gramatikë.

Duke parë këtë shpërndarje të fushës përkatëse kemi ndjekur dhe mbështetur mendimin e disa gjuhëtarëve ndër vite dhe sot mbi një ndarje më vete të fjalëformimit si disiplinë duke u bazuar në disa argumente gjuhësore.

Një vështrim historiko-krahasues mbi mënyrat e fjalëformimit me nëndarjet përkatëse, parë nën këndvështrime të gjuhëtarëve që janë marrë me to, na lejon të shohim prirjen e sotme të sistemit fjalëformues të shqipes.

Fjalë kyçe: Fjalëformim, mënyrë fjalëformimi, sistem fjalëformimi, lidhje dykahëshe, mëvetësi disiplinore, vështrim historiko - krahasues.

SHTESAT DHE RËNIET E TINGUJVE NË TË FOLMEN E HASIT TË PRIZRENIT NË PËRQASJE ME GJUHËN SHQIPE

Endresa Duraj

endresaduraj5@gmail.com

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"

Abstrakt

Ky punim ka objekt studimi proceset fonetike të së folmes së Hasit të Prizrenit, duke i pasqyruar ato nëpërmjet krahasimit me gjuhën shqipe, kryesisht me gjuhën e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë. Kjo e folme I përket grupit të të folmeve të gegërishtes verilindore, por me disa veçori dalluese.

Edhe shqipja e shek. XVI-XVII i kishte të pranishme këto fenomene fonetike në çdo pozicion të fjalës, si te Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani dhe Matrënga. Shtesat dhe rëniet e tinguj vejanë gjetur si në shkrimet e para geqe, ashtu edhe në ato toske. Kjo do të thotë se shqipja I kishte këto dukuri që prej shkrimeve të para të saj.

Gjatë punës sonë kërkimore kemi nxjerrë rezultatet se në të folmen e Hasit të Prizrenit më të shpeshta janë rastet e rënieve të tingujve (afereza, sinkopa, apokopa) sesa shtesat e tingujve (proteza, epenteza, epiteza). Fjalët që pësojnë këto procese fonetike janë forma dialektore, pra jashtë standardit të gjuhës shqipe.

E folmja e Hasit, ndonëse një varieteti gegërishtes verilindore, përbën një formë të veçantë në mesin e të folmeve të këtij grupi.

Studim i fushës së gjuhësisë

Fjalëtkyçe: e folmja e Hasit, proceset fonetike, krahasime

UDHËTIM NË FUND TË NATËS" SI EKSPERIMENT I JETËS NJERËZORE, SI REALITET TËRËSISHT I JASHTËM, HUMBJA E VETËDIJES, TURPIT DHE KONCEPTEVE

Enxhi Hoxha

Gjuhë-Letërsi

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë.

enxhihoxha0@gmail.com

Abstrakt

Në këtë punim, me në qendër një nga kryeveprat e letërsisë botërore "Udhëtim në fund të natës" e L.F.Selin jemi fokusuar në atë aspekt që na intrigoj që me leximin e parë. Bëhet fjalë për një vepër, në të cilën shquajnë teknikat postmoderne të rrëfimit, si e tillë ajo është pjesë e korpusit avangard të

artit të romanit..Që në titull sugjerojmë se ç'po trajtojmë : "Udhëtim në fund të natës"si eksperiment i jetës njerëzore, humbja e vetëdijes, turpiti dhe koncepteve. Një Botë të Trilluar postmoderne e përdorim si eksperiment për të shpjeguar se ç'ndodh me shoqërinë kur ajo zë të funksionojë me ligjet e botës së trilluar.

E kemi parë veprën si eksperiment përmes të cilit zbulohet njeriu i shoqërisë postmoderne, në analogji me personazhin postmodern selinian. Pyetja është e thjeshtë : -Çndodh me identitetin që vendos të jetojë me të tjeret duke shfaqur haptazi, pa asnjë lloj censure të brendshmen dhe të jashtmen e vet, kur e jashtëson mendimin e tij edhe pa patur vlerë paraprake, kur ai zgjedh t'i kryej veprimet kur ato kanë dobi vetëm për vete dhe jo edhe për vete edhe për të tjerët ? Nëse në Botën e Trillimit vëzhgimi brenda personazhit për të nxjerrë jashtë përjetueshmërinë e tij realizohet lehtësisht, në Botën e Njëmendtë praktikisht kjo gjë është e pamundshme. Nëse arrijmë brenda identitetit ashtu si në roman, edhe në realitet do të ndodhë e njëjta gjë, praktikisht asgjë. S'do të ketë nevojë për zhgënjim, humbje besimi sepse tanimë me përjetueshmëri të dalë jashtë, të shndërruar në vëzhgueshmëri, Bota e Njëmendësisë do të barazohet me atë të trillimit. Identiteti, tashmë i vetëmjaftuar me formën e vet nuk ka më për qëllim të komunikojë. Komunikimi do të realizohet vetëm në nivel shkëmbim mesazhi jo shkëmbim vlerash.Tashmë e vërteta e relativizuar, e subjektivizuar, e copëzuar e humb mundësinë për t'u përbashkësuar. Kështu humbet nevoja për të komunikuar.Duke treguar gjithkush çka brenda vetes, në kërkim të fiksimit të formës autentike të të vërtetës vetjake, atëherë ai do të shpallë impulset, pandehmat, mendimet e ulta, motivet e padenja. Në këtë mënyrë,ky identitet, tashmë i barabartë më një personazh humbet turpin, konceptet dhe vetëdijen.

Fjalë kyç: botë e trilluar, botë e njëmendtë, njeri postmodern,formë, përmbajtje.

SIMBOLI, GURI THEMELTAR I SHPREHJES GJUHËSORE TË VEPRËS SË BUXATIT

Eraldo Hatija
Universiteti "I.Qemali"
Vlorë
eraldo.hatija@yahoo.com

Abstrakt

Ndër elementët letrarë shprehës të letërsisë së shek. XX, një vend të rëndësishëm zë edhe simboli e simbolika, ndaj edhe zgjodhëm të trajtojmë rolin e kësaj simbolike në veprën e shkrimtarit Dino Buxati.

Në veprën e tij, Dino Buxati, njëri prej shkrimtarëve më të njohur italianë na shfaqet si mjeshtër i simbolit. Ai luan me elemente estetike të peshës së rëndë, të tilla si absurdi, paradoksi, një paradoks

deri në absurd, alegoria, nënteksti e për të arritur kështu te simboli, ku cilido simbol përçon nga një mesazh të caktuar e shpeshherë universal.

Gjykuar prej stilit të tij, gjykim ky, zhvillimit të të cilit do t'i kushtohet një hapësirë e mirë në trajtesë, na duket sikur Buxati është një shkrimtar i realizimit magjik, ndaj edhe mund të themi se së paku, koha nuk është treguar dorërrudhur me ne, duke ia falur edhe Europës një shkrimtar të tillë.

Sërish, në trajtesë do të studiohen roli që luajnë paralelizmat figurativë, elementët mikro dhe makro në vepër, sendërtimi i situatave dhe ndikimi e roli i tyre në raport me të tërën si edhe mënyra e përçimit të mesazhit. Për ilustrim të gjithë hollësive të përmendura të mendimit estetik të veprës, sjellim më poshtë në raport nën një drtë interpretative edhe disa nga tregimet e vetë autorit, në pamundësi për të trajtuar e analizuar gjithë veprat e tij.

SHQYRTIM SEMANTIK I DISA FJALËVE DHE FRAZELOGJIZMAVE NË DEÇAN DHE RRETHINË

Ermerinda Zekaj

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"

rinda.z@hotmail.com

Abstrakt

Punimi "Shqyrtim semantik i disa fjalëve dhe frazeologjizmave në Deçan dhe rrethinë" trajton një anë të veçantë të fjalës, siç është kuptimi. Por, në këtë punim nuk do të trajtojmë kuptimin e zakonshëm, që e karakterizon çdo fjalë. Themeli i punimit janë fjalët, që marrin kuptime figurative gjatë ligjërimit të lidhur, lidhjet e fjalëve, vlerat e ngjyrimet për të kaluar te frazeologjia si ti pari ligjërimit bisedor. Shembujt do të jenë pasqyrim i një ane të fshehtë të fjalës, ku do të veçohen fjalë dhe frazeologji, të cilat po kalojnë në shtresën e leksikut pasiv.

Ndonëse në titull theksohet që bëhet fjalë për shembuj nga rrethina e Deçanit, në realitet të gjithë folësit e shqipes mund ta gjejnë veten brenda këtij punimi, pasi që ana fonetike dhe topika nuk e kanë kushtëzuar anën kuptimore. Ngjyresat emocionale janë të ngjashme, këtë e dëshmojnë kuptimet e fjalëve po të krahasohen me kuptimet e fjalëve gjegjëse në të folme të ndryshme të gegërishtes verilindore. Fjala shënon një realitet më të gjerë se vetja dhe kuptim i ka një natyrë komplekse, aq sa krahas fjalëve, që kanë vetëm ngjyrimet pozitive ose negative, ekzistojnë edhe ato, që i kanë të ngatërruara ngjyrimet ose e njëjta fjalë kur lidhet me të tjerat i përcaktohet kuptimi.

Studim në fushë të gjuhës shqipe

Fjalët kyçe: fjalë, njësfrazeologjike, kuptim, ngjyrimet figurative, pasurileksikore.

SINTAGMA EMËRORE DHE VEÇORI SEMANTIKE NË VEPRËN E REBI ALIKAJ

Ersila Hoxha

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

hoxhaersila@yahoo.com

hoxhaersila@gmail.com

Abstrakt

Shqyrtohet konceptimi i sintagmës emërore dhe aspektit semantik në krahinën e Labërisë me të gjitha nëndialektet dhe nënzonat e tjera që bëjnë pjesë në të folmen e Toskërishtes Jugore. Teoria e sintagmës mundëson vendosjen hierarkike të fjalëve në sintagmë, duke zbuluar kështu edhe marrëdhëniet strukturore e gramatikore të krijuara brenda fjalisë.

Nënvizohet prirja se mbi 90% në të gjitha nëndialektet e Labërisë, përdoret më tepër sintagma emërore. Denduria leksikore është një tipar dallues në krijmtarinë e këtij autori. Fjalët e zgjedhura për denduri bien lehtë në sy, ato i përkasin si botës material edhe asaj shpirtërore.

Fjalëkrijimet e tij janë ndër më të bukurat dhe me interes, jo vetëm për gjuhën artistike, por edhe për atë letrare. Mund të themi se ai i përdor me sukses të gjitha modelet fjalëformuese të shqipes, ndonëse mbizotëruese janë fjalët e krijuara me anë të prejardhjes dhe kompozimit.

Ai zgjeroi figurshmërinë e shqipes, pasuroi leksikun poetik, duke figurativizuar edhe fjalët më të zakonshme të gjuhës. Rebiu, me anë të veprës së tij, jo vetëm ripërtëriti, por edhe i zgjeroi dhe rikuptimësoi semantikisht një numër të konsiderueshëm njësisish leksikore.

Fusha: Gjuhësia

Fjalë kyç: sintagma emërore, lidhje gramatikore, lëvizja semantike, denduria leksikore, fjalëkrijime.

NJË VËSHTRIM PSIKOLINGUISTIK I LAPSUSEVE NË GJUHËN SHQIPE

Esma Allmuça

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

Universiteti i Tiranës

Master Shkencor Gjuhësi

esmaallmuca@gmail.com

Abstrakt

Interesi kryesor i këtij punimi ishte që, së pari, të vihej në qendër të vëmendjes fenomeni i lapsuseve ose shkarjeve të gojës (gjuhës). Lapsuset janë një dukuri gjuhësore që tërheq vëmendjen e folësve dhe po ashtu kanë zgjuar interesin e studimeve me natyrë psikologjike dhe psikolinguistike duke i lënë hapësirë kështu qasjeve të ndryshme mbi interpretimin e tyre. Mandej, synimi ishte të shihej

diferencimi i këtyre qëndrimeve. Qasja më e njohur për interpretimin e lapsuseve, është ajo e Z. Frojd, i cili i sheh lapsuset si një shpërfaqje të instinkteve, mendimeve, ideve të shtypura në pavetëdije. Nga ana tjetër psikolinguistët i shohin gabimet e të folurit si evidenca të mirëfillta gjuhësore përmes të cilave mund të sigurojnë informacion se si komponentët e ndryshëm të sistemit të prodhimit të të folurit funksionojnë e se si këto gabime *nuk janë të rastësishme*, por realizohen në një mënyrë krejtësisht të organizuar dhe ndjekin disa "rregulla" apo modele. Klasifikimi i lapsuseve në disa lloje dhe konkretizimi i tyre përmes rasteve të identifikuar ka bërë që të sqarohet më së shumti kjo dukuri që prek shpesh materialin e zakonshëm të bisedës në gjuhën amtare të imunizuar ndaj harresës, por jo ndaj këtij turbullimi, të njohur në emrin e lapsusit.

Fjalët kyçe: lapsus, psikolinguistikë, psikologji, evidenca gjuhësore

RRUGËT SOCIOLINGUISTIKE PËR FORMIMIN E SHQIPES STANDARDE

Fahrije Smakiqi

Universiteti i Gjakovës " Fehmi Agani "
fahrije.smakiqi@hotmail.com

Abstrakt

Në këtë punim do të trajtohen rrugët sociolinguistike të formimit të shqipes standarde, çështjet që kanë të bëjnë me statusin e shqipes standarde, me domenet dhe situatat e përdorimit dhe me qëndrimet ndaj saj. Do të trajtojmë një zhvillim të shqipes së shkruar, politikës gjuhësore dhe planifikimit gjuhësor; përpjekjet e rilindësve për shqipen standarde, vendimet, parimet rreth standardizimit të shqipes, bazën dialektore të standardit, lidhjet e dialektit me gjuhën; se si funksionon shqipja standarde në etapën e sotme. Po ashtu, do të prezantojmë shembuj të ndryshëm rreth pikëpamjeve për gjuhën letrare shqipe dhe për normëzimin e shqipes së shkruar. Do të japim një përshkrim të historisë së popullit shqiptar, që la gjurmë në njësimin e gjuhës kombëtare.

Gjuhë standarde quhet një varietet i veçantë lingvistik i një gjuhe, i cili ka prestigj të lartë brenda një komuniteti gjuhësor. Shqipja standarde sot është një varietet që përdoret në të gjitha veprimtaritë si: administrata, mediet, sistemi arsimor, por edhe në këto drejtime ajo përdoret kryesisht në situata formale si një varietet "i lartë".

Në punim, gjithashtu, është paraqitur gjendja në zbatimin e normës drejtshkrimore dhe drejtshqiptimore të shqipes standarde. Gjuha standarde është pjesë e gjuhës së popullit, por e ngritur në normë sipas kriterëve shkencore. Nga ky konstatim kuptohet se varianti standard dhe koineja dialektore janë të pandashme dhe, si të tilla, ato paraqesin një unitet makrogjuhësor. Formimi i gjuhës letrare kombëtare të njësuar (gjuha standarde), si varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar,

ka qenë një proces i gjatë, që ka filluar që në shekujt XVI-XVIII, por përpunimi i saj hyri në një periudhë të re, në shekullin XIX, gjatë Rilindjes Kombëtare.

Studim në fushë të gjuhës shqipe

Fjalët kyçe: gjuhë standarde, histori, dialekt, pikëpamje, varietet.

PËREMRI PRONOR SIPAS GRAMATIKAVE TË GJUHËS SHQIPE

Msc. Grisilda Telhaj

Universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan

Fakulteti i Shkencave të Edukimit

MP "Gjuhë shqipe dhe Letërsi"

grisildadulellari@gmail.com

Abstrakt

Megjithëse përemri pronor në gjuhën shqipe është trajtuar në çdo gramatikë, disa çështje mbeten ende objekt diskutimesh. Në këtë studim do të krahasohet trajtimi i përemrit pronor në gramatikat më përfaqësuese të shqipes, si: "*Gramatika e gjuhës shqipe*", Kostandin Kristoforidhi; "*Shkronjëto e gjuhës shqipe*", Sami Frashëri; "*Gramatika e gjuhës shqipe*", Gjergj Pekmezi; "*Gramatika e sintaksa e gjuhës shqipe*", Ilia Dilo Sheperi; "*Gjuha e shkruese ose vërejtje gramatikore*", Justin Rrota; "*Gramatika e gjuhës shqipe*", Kostaq Cipo; "*Gramatika Albaneze*", Namik Resuli; si edhe "*Gramatika e gjuhës shqipe*", botimi i Akademisë së Shkencave, dhe "*Gramatika praktike e gjuhës shqipe*", Mehmet Çeliku, Mustafa Karapinjalli dhe Ruzhdi Stringa.

Arsyeja pse kemi ndërmarrë këtë studim është që të nxjerrim në pah karakteristikat e përemrit pronor të përshkruara në gramatikat e sipërpërmendura. Do të shohim këndvështrimet e autorëve për përemrin pronor, konceptimin e tij në përkufizimet përkatëse dhe terminologjinë e përdorur, mënyrën e klasifikimit dhe kategoritë gramatikore që i njihen, për të bërë një panoramë të zhvillimit të trajtimit shkencor për përemrin pronor në gjuhën shqipe.

Qëllimi i këtij studimi konsiston në hulumtimin e nxjerrjen në pah të çështjeve të diskutuara e shtrimit e disa çështjeve problemore për sa i përket trajtimit të pronorëve në shqipe.

Metoda që kemi ndjekur për të realizuar këtë punim shkencor është metoda krahasuese. Ne do të krahasojmë gramatikat më në zë të shqipes në tre pika kryesore: përkufizimi, zgjidhjet e njëjta dhe këndvështrimet e ndryshme.

Fjalë çelës: përemër pronor, gramatikë, kategori gramatikore, krahasim dhe terminologji

LIGJËRIMI POLITIK

(Trajtim të aspekteve teorike, zbatimi i tyre në fjalimin e "Lamtumirës", ndikimi i ligjërimit politik në shoqëri.)

Habi Hoxha

Fakulteti Filologjik

Dega: "Gjuhë-Letërsi"

habi.hoxha@outlook.com

Abstrakt

Ky punim pretendon të trajtojë në shtrirjen e tij disa prej problemeve kryesore teorike që lidhen me ligjërimit politik, duke filluar prej lindjes së retorikës me në thelb kërkesën e fuqishme për të bindur, tek vlera e fjalës, pesha dhe rëndësia e veçantë që i kushtohet sidomos në rastet e ligjërimeve të dedikuara për publikun, lidhja e ligjërimit politik me disiplinën e sociolinguistikës e më tej, pas dallimit mes gjuhës dhe ligjërimit, trajtimi i çështjeve që lidhen me artin e të folurit, kulturën e gjuhës, si dy shtylla ku mbështetet fort ky ligjërimit.

Vlen për t'u pasur parasysh se para së gjithash duhet bërë një qasje e qëndrueshme ndaj përkufizimeve për fjalimin dhe elementëve të tjerë politik ndihmës, sikurse janë mekanizmat emocional përdorur gjatë zhvillimit të fjalimit. Pjesa e mëtejshme synon të ndërtojë një analizë më të drejtpërdrejtë duke prekur rastin e "fjalimit të Lamtumirës" të politikanit Sali Berisha, parë nën hijen e trajtimeve teorike të parashtruara, përmes propozimeve të Fairclough-it dhe shenjave të tjera që pulsojnë në tekstin e fjalimit.

Ndikimi i ligjërimit politik në shoqëri vjen përmes leximit të mendimeve shprehur nga vetë faktorë të shoqërisë.

Fjalë kyçe: ligjërimit politik, sociolinguistik, retorik, kultura e gjuhës, arti i të folurit, mekanizma emocional.

MOTIVET BIBLIKE DHE PËRKTHIMI I CENSURUAR I ROMANIT "ROBINSON KRUIZO" I DANIEL DEFOSË

Ledio Hala

UT

Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë

Dega: Gjuhë-Letërsi

lediohala1@gmail.com

Abstrakt

Përkthimi i letërsisë së huaj në Shqipëri ka qenë gjithmonë detyrë e përkthyesve, ashtu si ka qenë dhe është detyrë e kritikëve letrarë dhe të përkthimit që të analizojnë mënyrën e përkthimit dhe të arrijnë në një interpretim të veprës letrare. Në këtë mënyrë është mundësuar zhvillimi i letërsisë në Shqipëri,

janë siguruar kontakte me letërsinë botërore, si dhe janë mundësuar shtigje krahasuese me letërsinë shqipe. Por, në periudhën e sistemit komunist edhe përkthimi, edhe kritika mbi përkthimin funksiononin në zbatim të ideologjisë së kohës. Kështu, ajo që për ne tashmë është e dukshme dhe jep mundësi të reja interpretimi, dikur ka qenë e padukshme. Bëhet fjalë për censurën që i është bërë letërsisë së huaj në periudhën e regjimit komunist në Shqipëri. Kjo censurë bëhej për arsye ideologjike, por edhe fetare. Në këtë punim kemi marrë si shembull tipik romanin "Robinson Kruzo" të Daniel Defosë, ku të gjitha pjesët tekstore që kanë të bëjnë me Zotin dhe Biblën shfaqen fillimisht në variantin e vitit 1966, censurohen të gjitha në variantin e vitit 1982, derisa rishfaqen përsëri në variantin e vitit 2000. Do nxjerrim në pah dhe do shpjegojmë të gjithë censurën që i është bërë romanit në përkthim, për të kuptuar që ajo që është bërë me letërsinë në vitet e diktaturës është po aq e tmerrshme sa prishja e vendeve të shenjta, duke sjellë deri në letërsi të painterpretuar.

Fjalë kyçe: motive biblike, përkthim, i censuruar, letërsi e painterpretuar.

NJË VËSHTRIM HISTORIK I KATEGORISË SË RASËS NË GJUHËN SHQIPE

Myzejen Kashari

Univesiteti "A.Xhuvani" Elbasan
Master shkencor, Dega: Gjuhësi
myzejenkashari@gmail.com

Abstrakt

Që në kohët prehistorike në gjuhët indo evropiane është zhvilluar një sistem formash rasore, nëpërmjet të cilave shpreheshin lidhjet sintaksore të emrit. Gjuha shqipe si degë e veçantë e gjuhësisë e familjes indoevropiane ka ndjekur një rrugë zhvillimi që ndryshon nga gjuhët e tjera dhe sidomos e veçanta qëndron në lakimin e emrave ku shqipja në krahasim me sistemin e trashëguar ka pësuar ndryshime të mëdha. Pikërisht këto ndryshime vërehen dhe në veprat e studiuesve të huaj dhe shqiptarët e cilët i kushtuan një rëndësitë veçantë studimit rasortë emrit. Gjuhëtarët e huaj si: Da Leçe, Marti Link, Rainhold dhe Georg fon Hahn në veprat e tyre kanë treguar interes në studimin e gjuhës shqipe, duke paraqitur numrin e rasave të emrit. Në të vërtetën këto vepra vërehen dallimet që ekzistojnë përse i përket numrit të rasave nga një gramatikë në tjetrën. Përse i përket sistemit rasor të gjuhës shqipe një vend të veçantë zënë edhe veprat e studiuesve tanë si: De Rada, Dozoni, Kristoforidhi, Sami Frashëri, Pegmezi, Sheperi, Myderrizi dhe Cipo, duke na paraqitur një numër të ndryshëm rasash.

Sidoqoftë, ndryshimet që kanë ndodhur në sistemin rasor janë risi të evolucionit të brendshëm, që kanë përcaktuar kalimin e shqipes nga një fazë më e hershme zhvillimi në një fazë më të re. Duke iu referuar këtij studimi një gjë është e dukshme: sistemi I lakimit emëror është riorganizuar për një

periudhë të gjatë kohe dhe shqipja ka vijuar të bëjë ndryshime të këtij sistemi, gjë që del në dritë nga krahasimi i këtyre veprave duke arritur deri në sistemin rasor që studiohet sot në shqipen e ditëve tona.

Fjalët kyçe: sistemrasor, gjuhëtare te huaj, studuesit tanë, zhvillim i shqipes, numri i rasave

PËRDORIMI I ZANORES – Ë – FUNDORË NË PUNËT ME SHKRIM (KL. 8-9)

Nevruze Bollobani

Rexhersa Xheka

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan

Fakulteti i Shkencave Humane

Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë shqipe dhe letërsi Drejtshkrim

nevibollobani24@gmail.com

rexhersaxheka@yahoo.com

Abstrakt

Është fakt i pakundërshtueshëm konstatimi se nxënësit tanë bëjnë një sërë gabimesh drejtshkrimore, madje që çojnë edhe në gabime gramatikore e semantike. P.sh., kalimi nga një kategori leksiko-gramatikore në një kategori tjetër: nga mbiemër në ndajfolje, si: i fortë/mb dhe fort/ndajf. në fjalinë Ai bërtiste fortë.

Këto gabime çojnë natyrshëm në formulimin e disa pyetjeve problemore: Pse vazhdojnë të shkruajnë ende me gabime, madje duke u shtuar edhe numri i tyre nxënësit e kësaj moshe? Në ç'mënyrë, metoda pune, mjete gjuhësore e metodike mund t'i ngulisin nxënësit tanë këto rregulla drejtshkrimore, duke i bërë natyrshëm pjesë të vetëdijes së tyre gjuhësore si shkrues amtarë? Etj.

Këto pyetje problemore do të na udhëheqin në këtë punim duke përbërë hipotezat kryesore, të cilave do të mundohemi t'i japim përgjigje, duke u mbështetur në të dhënat gjuhësore e statistikore që kemi vjelë nga punët me shkrim të nxënësve të kl. 6-9.

Çështja kryesore që kemi trajtuar është – ë – ja fundore.

Metoda kryesore e këtij punimi është metoda kërkimore.

Lëndën gjuhësore e kemi vjelë në punët me shkrim të klasave të 8-ta (94 nxënës) dhe të 9-ta (87 nxënës), të shkollës 9-Vjeçare "35 Vjetori i Çlirimit", Elbasan.

Fjalë kyçe: gabime drejtshkrimore, mosha shkollë, punët me shkrim, vetëdije gjuhësore.

DRITËRO AGOLLI POET I TOKËS (RASTI: "TË PAGJUMËT" DHE "LYPËSI I KOHËS")

Rovena Vata

Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë
Studime letrare
rovena_vata@hotmail.com

Abstrakt

Ka personalitete të kulturës sonë që dallohen për thjeshtësinë e veprës së tyre, qoftë nga forma apo nga përmbajtja, të cilët bashkë me veprën sjellin edhe një pjesë të shpirtit të tyre, e njëjta gjë ka ndodhur edhe me atë që e quajtmë poetin e tokës-Dritëro Agollin, i cili të gjithë botën shpirtërore të tij e derdh në letër.

Dashuria e këtij poeti për tokën është e madhe, siç është edhe simbolika e saj. Njeriu për të cilin këndon Dritëro Agolli është i lidhur me tokën si mishi me thuan. Toka është djepi dhe varri, lumturia dhe fatkeqësia e tij. Ai nuk jeton dot pa të. Nga kjo dashuri e madhe e poetit për tokën del edhe ekuacioni TOKA IME-KËNGA IME .

Poeti e kishte mësuar nga i ati që nuk duhet ta shante tokën, pasi ajo të jep bukën dhe duhet të trajtohet me dashuri. Në këto dy cikle toka na del në këto marrëdhënie të rëndësishme si: tokë-njeri, tokë-atdhe-vendlindje, tokë-punë, tokë-krijimtari intelektuale, shpirtërore etj. Në këtë optikë, toka dhe njeriu janë një binom jetësor e filozofik i pazgjidhshëm, madje paraprihen nga ajo që quhet tokë, simbol i jetesës së thjeshtë popullore dhe fëmijërinë, simbol i bukurive njerëzore dhe natyrore, simbol i ëndrrës, i lirisë, përparimit, mirëqenies, harmonisë shoqërore.

Fjalë kyçe: Toka, parmenda, opinga, bujku, njeriu

ËNDRRA SI REFLEKTIM I TË BRENDSHMES, TË FSHEHTËS DHE MISTIKES NË ROMANIN "LUMI I VDEKUR" I JAKOV XOXËS

Ana Shahini

(phd candidate – Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë)
anashahini@hotmail.com

Abstrakt

Jakov Xoxa është një shkrimtar i cili gjithnjë nga kritika letrare është parë si autor i realizmit, madje për disa edhe si autor i realizmit sociallist. Ndërkohë, në kohët e sotme e parë nga një optikë e re leximi dhe interpretimi, gjejmë të shtresëzuar në tërësi të romanit "Lumi i vdekur" edhe elemente të dukshme, të gjalla, e të thella psikoanalitike, me elemente të shumta, ku një ndër to është edhe ëndrra.

Ëndrra shfaqet herë si shprehje e së pavetëdëshmes së personazheve e herë si botë mistike dhe mitike e qenies njerëzore, madje edhe si mjet i përthyerjes apo ngritjes së kohës narrative në veprë. Bashkangjitur një infomacioni të thellë e të gjerë teorik mbi psikologjinë, gjejmë të ilustruara nga teksti edhe shembuj ku vepra vërteton gjithçka është thënë teorikisht nga studiues të shumtë të fushës përkatëse, ku letërsia dhe psikoanaliza duket se janë substrat i njëra-tjetrës si dy enë që ushqejnë mjaft mirë njëra-tjetrën e mbi të gjitha ndërtojnë një semantikë të re vështrimi mbi veprën në fjalë.

Fusha e studimit: Studime Letrare

Fjalët kyçe: Ëndër, e pavetëdëshme, qenie, individ, simbol.

KONTRIBUTI I REVISTËS “ALBANIA” NË ALBANOLOGJI

Anita Tafani

Udhëhoqi: Prof. Asc. Dr. TEUTA TOSKA
Universiteti I Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Gjuhësisë
anita.adi.2013@gmail.com

Abstrakt

Revista “Albania” është një nga të përkohëshmet më të rëndësishme të fund shek. XIX dhe fillim shek. XX. Kontributi që ajo dha në zhvillimin e gjuhës shqipe dhe bashkimin e popullit shqiptar nuk ka të krahasuar. Artikujt e shumtë të publikuar gjatë viteve në revistën “Albania” luajtën një rol pozitiv dhe të pazëvendësueshëm në lëvizjen mendore shqiptare, si tribunë e letërsisë dhe e shkencave albanologjike.

Roli i “Albania”-s konsistoi në themelimin e gjuhës letrare, në njësimin e dy kryedialekteve të shqipes, në lidhjen e shqiptarëve dhe zgjimin në ta të ndjenjave patriotike, në hartimin e një alfabeti përfundimtar, të zhveshur nga ndikimi turko-grek e ai sllav.

“Albania”, si revistë politike, kulturore e letrare ka luajtur një rol thelbësor midis të gjitha organeve të tjera të shtypit të Rilindjes Kombëtare shqipëtare, në pasurimin e kulturës kombëtare shqiptare në saj të artikujve të saj letrare, gjuhësorë, historik, folklorik dhe enciklopedik.

Fjalë kyçe: publicistika, albanologjia, e përkohëshmjia “Albania”, njësimi i gjuhës shqipe, alfabetimi i shqipes, alfabeti i “Bashkimi”-t; abëja, shqipo-turke.

GABIMET DREJT SHKRIMORE E TË RINJVE NË RRJETE SOCIALE

Donika Bakiu

FGJJK , UEJL – Tetovë

Maqedoni

db20787@seeu.edu.mk

Abstrakt

Mediat sociale i referohen mjeteve të ndërveprimit midis njerëzve në të cilët krijojnë, ndajnë dhe / ose shkëmbejnë informacione dhe ide në rrjetet sociale. Rrjetet sociale të cilat përdoren më shumë janë: Facebook -si një ndër më të vizituarat , Tëitter, Instagram, Snapchat,LinkedIn, etj. Të rinjtë kanë mjaft probleme në tëshkruarit e gjuhës sonë amtare. Bëjnë gabime të shumta drejtshkrimore. Gabimet drejtshkrimore , për fat të keq, janë një fenomen i zakonshëm në rrjetet sociale. Në këtë punim kemi shembuj ku më shumë gabohet në drejtshkrim në rrjete sociale, ku gabojnë të rinjtë më shumë. Njohja e gramatikës dhe drejtshkrimit është shumë e dobët nga të rinjtë. Të rinjtë shpesh i promovojnë postimet e tyre në rrjete sociale me shumë gabime drejtshkrimore

Fusha e studimit : Studime Albanologjike

Fjalët kyçe: rrjete sociale, gabime drejtshkrimore, të rinjtë

RENDI I PËRBËRËSVE NË FJALITË DËSHIRORE

(Mbështetur në romanet “Lumi i vdekur” dhe “Juga e bardhë” të Jakov Xoxes)

Elgert Dhima

Universiteti “Aleksander Xhuvani”

Elbasan

gertidhima4@gmail.com

Abstract

Rendi, si një ndër elementët e përcaktimit të përbërësve sintaksorë në fjali është trajtuar pak në gramatikën e shqipes dhe ato pak hulumtime që janë kryer, kanë patur si objekt punimi fjalinë dëftore. Është arritur, megjithatë, të përvijohet një përfundim i kënaqshëm mbi këtë çështje, gjë e cila na mundëson edhe kryerjen e këtij punimi, i cili ka për objekt pikërisht rendin e fjalëve në fjalinë dëshirore, duke u mbështetur pra, te modelet e fjalisë dëftore dhe duke patur si qëllim krahasimin e këtyre modeleve për të nxjerrë në pah dallimet dhe ngjashmëritë midis këtyre dy lloj fjalive.

Duke synuar gjithmonë për vijimin e një punimi të arrirë, me baza të shëndosha teorike e faktike, në kuadër edhe të gjuhësisë strukturaliste, jemi mbështetur mbi një material të përzgjedhur e të bollshëm. Nga ana faktike kemi përzgjedhur veprat e autorit J. Xoxe, “Lumi i vdekur” dhe “Juga e bardhë”, kjo për vetë faktin se gjuha e përdorur në këto vepra është një gjuhë me karakter më tepër popullor se

letrar, çka është mjaft e domosdoshme për trajtesën tonë sepse rmodele do të merren fjalitë dëshirore dhe këto lloje fjalishka në larmishmëri dhe përdorueshmëri më të madhe në gjuhën e popullit.

Për sa i përket materialit teorik, edhe këtu kemi synuar shfrytëzimin sa më të bollshëm të gramatikave shqiptare, studimeve, artikujve, punimeve shkencore për ta bërë samë të plotë punimin, por edhe për t'i patur sa më të qarta konceptet shkencore të përdorura këtu. Mbështetja dhe referimi mbi këtë material do të na mundësojë arritjen e përfundimeve sa më të sakta nëpërmjet një metodologji e krahasuese-përshkruese.

Për ta përmbyllur, duke u fokusuar te rendi I fjalëve, si një mjet gramatikor pak i trajtuar në gjuhësinë tonë, ecim me bindjen se ky punim do të jetë diçka e re dhe e vlefshme në kuadër të sintaksës së gjuhës shqipe.

ZHVILLIMI DHE PASURIMI I LEKSIKUT TË SHQIPES (PËRMES VEPRAVE ‘APOLOGJI E SKËNDERBEUT, ‘OXHAKU’ ‘QYTETI PA REKLAMA’)

Evgjeni Selimaj

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"

Vlorë

evgjenism@gmail.com

Abstrakt

Gjuha shqipe ka ndryshuar dhe është zhvilluar shumë me kalimin e kohës. Ky ndryshim dhe zhvillimi ka shërbyer vetëm për pasurimin e saj. Vetë pasurimi është bazuar tek gjuha e popullit, si burimi kryesor i zhvillimit të gjuhës sonë, duke u mbështetur edhe në mendimet dhe objektivat që njerëz të shquar dhe intelektualë të ndryshëm e të mëdhenj të këtij vendi i kanë vënë vetes, për një gjuhë shqipe të pastër dhe të zhvilluar. Sigurisht kjo nuk ka ndodhur për një kohë të shkrutër. Është dashur një periudhë shumë e gjatë kohe për të arritur në gjuhën që përdorim sot.

Zhvillimi dhe pasurimi i gjuhës shqipe është bërë me mjetet dhe format gjuhësore të shqipes, duke u bazuar në gjuhën vetjake. Ajo i ka shfrytëzuar këto mjete në fjalëformim, në zgjerimin e leksikut, dmth ndjashtesat e ndryshme të gjuhës shqipe, fjalëformimin me bashkim temash, si dhe formimin e fjalëve të reja duke marrë si temë një fjalë të huazuar nga gjuhë të tjera, me të cilat është ndeshur gjuha shqipe e shkruar gjatë rrugës së saj prej afro 500-vjeçare.

Një tipar tjetër i tre autorëve tanë është edhe pasurimi i gjuhës nga ana kuptimore, ku sinonimet luajnë një rol shumë të rëndësishëm. Njësitë frazeologjike janë një nga pasuritë më të rëndësishme të gjuhës

sonë. Këtë e gjejmë të reflektuar më së miri te tre autorët e tri periudhave, përfaqësues të të cilëve janë Frang Bardhi, Mihal Grameno e Ismail Kadare.

Dallimi kryesor i gjuhës shqipe në këto tri periudha është drejtshkrimi. Në leksikon e Frang Bardhit dhe të Mihal Gramenos gjejmë shumë fjalë dialektore dhe krahinore, ndërsa në gjuhën e Ismail Kadaresë këto janë tejkaluar plotësisht.

Gjatë analizës gjuhësore të një cope të veprës “ Apologji e Skënderbeut” të autorit tonë të mirënjohur të periudhës së Mesjetës, Frang Bardhi kam vënë re se gjuha e tij është mbështetur fort në tabanin e gjuhës së popullit, pra një gjuhë me një bazë të gjerë të burimit vetjak. Por kemi edhe disa fjalë me burim të huaj. Njësitë frazeologjike zënë një vend të mirë në leksikon e kësaj vepre, gjë që tregon për pasurinë e gjuhës sonë që në kohët më të vjetra të saj. Kjo vërehet edhe në fjalët që janë zhvilluar si kuptime të reja semantike e leksikore nga disa fjalë që kanë shërbyer si rrënjë e tyre.

Tipar tjetër dallues në këtë vepër është fjalëformimi. Kemi shumë fjalë të cilat janë të prejardhura me formim ndajshesor ku më të spikatura janë parashtesat për-, ndër-, para-, dhe prapashtesat –ri, dhe –or. Po kështu kemi edhe fjalëformimin nga rrënjë, pra çerdhe fjalësh nga një fjalë e vetme. Fjalët me burim të huaj zënë një vend të caktuar në fjalorin e këtij autori. Më shumë prej tyre janë të burimit turk. Në këtë material gjejmë pak fjalë të përbëra, si psh. lartpërmendur, kryekomandant, parashtroj, paraardhës.

Nga studimi i veprës “Oxhaku” të Mihal Gramenos vërehet se një vend të rëndësishëm zënë fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra me dy tema fjalëformuese. Njësitë frazeologjike edhe te Gramenoja, ashtu si te vepra e Bardhit, zënë një vend të rëndësishëm. Kujtojmë këtu se gjuha shqipe ka mbi dhjetë mijë njësi frazeologjike dhe këto përbëjnë një pjesë të mirë të burimit popullor të gjuhës. Sinonimet janë një veçori tjetër të gjuhës së Gramenos në veprën e tij letrare dhe ajo është më tepër dialektore dhe krahinore. Fjalët e huaja zënë shumë pak vend dhe ato janë fjalë të burimit grek dhe turk. Përgjithësisht fjalitë janë të gjata dhe me shumë pjesë të cilat ndërtohen si fjali nënrenditëse homogjene. Shumë fjalë shërbejnë në fjali si fjalë homogjene.

Në lidhje me tiparet dalluese të gjuhës së Kadaresë, në veprën e tij “Qyteti pa reklama” gjejmë fjalëformimin me bazë nga tabani i shqipes si një nga elementet më të spikatura. Fjalët me prejardhje ndajshesore kanë një denduri në të gjitha klasat morfologjike. Një tipar dallues i leksikut të kësaj vepre është krijimi i fjalëve të reja, 8 fjalë në një fjalor orej 2223 fjalësh. Po kështu kemi edhe shumë fjalë të ndërtuara me bashkim temash.

Fusha e studimit: gjuhë shqipe

Fjalë kyçe: pasurimi i leksikut, veçori leksikore, ngjashmeri dhe dallime

POETIKA SHQIPE SIPAS SABRI HAMITIT

PhD cand. Fitim Veliu
Koloegji "Mehmet Akif"
Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Fakulteti i Filologjisë
e-mail: fita_aj@hotmail.com

Abstrakt

Kërkimet letrare shqiptare, sidomos në fushën strukturale, përbëjnë një variant të mundshëm kërkimi në rrugën e përkufizimit të poetikës letrare shqiptare. Studiuesit e letërsisë shqipe kanë dhënë shenja dhe prova për një përkufizim dominant të studimeve letrare në domenin e strukturës teorike, kritike dhe asaj poetike. Në një rend kërkimi dhe analizë studimi, Letërsia shqipe po e përjeton një sprovë të vetpërkufizimit drejt provës letrare në hapësirën shqiptare. Studiuesit dhe kritikët e letërsisë shqipe, Rugova, Hamiti e Shala tashmë kanë dhënë provat e tyre për një "Poetikë Shqipe". Rugova me kërkimet letrare në fushën e kritikës shqipe, Hamiti me veprën "Poetika Shqipe" dhe Kujtim Shala me tekstin "Epistemiologjia e dytë".

Fjalët çelës: Poetika shqipe, Sabri Hamiti, Ibrahim Rugova, kërkimet, studimet.

VËSHTRIM KRAHASUES I TË FOLMES SË FIERIT DHE TROPOJËS

Gentjana Ukcamaaj
ukcamaj.gentjana@gmail.com

Abstrakt

Ky punim shkencor synon të japë një pamje tërësore mbi ruajtjen dhe risitë e të folmes së Nikaj-Mërturit nga një popullsi e zbritur nga Tropoja në një mjedis të Rrethit të Fierit, vështruar në rrafshin fonetik, morfologjik, në sintaksë dhe leksik.

Materialet janë vjelë nga kjo popullsi ardhëse (e ramun) në një bashkësi tjetër pritëse. Nga materialet e vjela dalim në përfundime se kjo e folme ka ruajtur elemente të saj të vjetër, por edhe ka pranuar risi nga bashkësia pritëse.

Punimi mbështet në burime të ndryshme dialektologjike, të cilat sjellin informacione me interes në këtë fushë studimore.

GJUHA QË PËRDORIN TË RINJTË NË FACEBOOK, SI PJESË E RRJETEVE SOCIALE

Nevila Naka

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
Fakulteti i Shkencave Humane
Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe
nevila.naka@yahoo.com

Abstrakt

Interneti dhe rrjetet sociale po ndikojnë gjithmonë në mënyrën se si ne e përdorim gjuhën. Njerëzit dhe veçanërisht të rinjtë po kalojnë shumë nga koha e tyre në rrjetet sociale, kjo sepse tashmë ato gjenden të instaluar në telefonat celularë apo tabletat të cilat të rinjtë i mbajnë çdo moment me vete. Si ndikon teknologjia dhe veçanërisht rrjetet sociale te gjuha? Ky punim synon që të hedhë dritë mbi gjuhën që të rinjtë përdorin sot në rrjetet sociale, veçanërisht facebook-ut përmes pyetësorëve të kryer me nxënës të shkollës së mesme. Nga studimi doli se si tipare të gjuhës së rrjeteve sociale vëmë re përdorimin e fjalive të shkurtra të përbëra me vetëm një fjalë. Për fjalë të veçanta hasim versione të ndryshuara të fjalëve si 'paçim' për mirupafshim, shkurtime për faleminderit 'flm', kalofsh mirë 'klm', zëvendësimin e fjalëve me ikona emocionale apo edhe përdorimin e shkurtimeve në gjuhën angleze, një tjetër tipar që vihet re është edhe kombinimi i shkronjave dhe numrave për fjalë si vërtet-vër8. A përbëjnë rrjetet sociale një rrezik që i kanoset gjuhës apo thjesht kontribuon në shtimin e një variant të ri gjuhësor? Duke qenë se gjuha është një organizëm i gjallë ajo po ndryshon dhe teknologjia, në rastin tonë rrjetet sociale, pjesë e të cilave është edhe facebook-u, po luajnë rolin e tyre në këtë ndryshim.

Fjalë kyç: rrjet social, facebook, gjuha, ndryshime gjuhësore.

E-LEARNING IN HIGHER EDUCATION INSTITUTIONS IN EUROPE

Albulena Veseli

University of Gjakova "Fehmi Agani"
English Language And Literature
albulenaveseli0@gmail.com

Abstract

E-learning as a recent practice used in higher education institutions is widely applied in universities throughout Europe. Its main benefits and the implications for students and lecturers are treated in the literature review. They served as an indicator to lead the focus of the paper toward the experiences of

developed countries in e-learning. The included countries are Germany, UK and Norway because their involvement in e-learning application in universities is long and they have invested great funds in taking projects which increased and helped e-learning spread. The research findings show that the main benefits of e-learning are the easy cross of country boundaries, courses offered in anytime, flexible teaching methods, the usage in different fields of study, inclusiveness, collaboration and communication teacher-student and among students themselves, content development and access to materials worldwide. From these, t̄eo important points which incorporate the benefits are e-learning orientation and fields of application. The adoption models and experiences in these three countries are taken as a benchmark for the recommendations considered in this study.

Field: Linguistics

Keywords: e-learning; higher education; e-learning orientation; fields of application.

BILINGUALISM AND ITS EFFECT ON EXPANDING CULTURAL BACKGROUND

Saranda Berisha

University Of Gjakova "Fehmiagani"
English Language And Literature
berishasaranda@outlook.com

Abstract

Recent studies on bilingualism have suggested that bilinguals have many advantages on different issues in contrast to monolinguals. This study examines the relationship between bilingualism and culture and the effects of them on expanding student's cultural background. Furthermore, literature review contains information about native language, dimensions and abilities of bilingual, benefits of bilingualism, the impact of it on cognitive development, advantages in cultural aspects, as well as the potential of bilingualism on internalizing cultures. To understand better the great impact of bilingualism on expanding cultural background, a questionnaire was distributed to twenty one students of different universities of Kosov̄e. Based on results, it could be said that everything that surrounds them, starting with learning the history of a particular country, changing their behavior while they switch on English language, meeting foreign people and learning through them their habits, tradition, culture as well as the impact of English on searching in internet, expands cultural background of participants. These results suggest that the sooner you learn the more frequently you use your second language, the greater benefits will be, from professional and personal to health benefits.

Field: Linguistics

Keywords: bilingualism; cognitive development; cultural background

HERMETIZMI NË POEZINE BASHKËKOHORE SHQIPE

Manjola Ramo

Universiteti i Vlorës

Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

Manjolaramo1@gmail.com

Abstrakt

Në punimin tonë të diplomës kemi marrë objekt studimi , shfaqjen e hermetizmit në letërsinë shqipe, në të cilën kemi kundruar disa aspekte të këtij fenomeni letrar, i cili është vënë pak në dukje nga kritika jonë letrare. Edhe pse studimet në këtë fushë kanë qenë të pakta , nga hulumtimi ynë kemi nxjerrë në dritë se mjaft autorë si: Camaj, Shkreli, Arapi, Spahiu, Reshpja, Zorba, Musliu këtë ndikim të letërsisë europiane e kanë mjaft të pranishëm. Hermetizmi u shfaq në Europë në fillim të shekullit të XX , fillimisht në Itali. Arturo Onofri ishte një nga futuristët që nisi rrugën e re artistike, atë të hermetizmit. Më pas u pasua nga Ungaretti, Quasimodo, Montale etj . Poezia u bë një akt besimi në vetvete, u bë shumë personale, e vështirë për tu kuptuar me një “efekt shok”, por njëkohësisht interesante, intrigante, objekt i thepisur që perceptohej ndryshe nga receptues të ndryshëm. Analogjitë politike e ato mitike ishin një nga rrugët e përdorura nga këta autorë në funksion të hermetizmit. Autorët hermetikë shqiptarë e përqaftuan këtë rrymë për shumë arsye që lidheshin me ata vetë si poetë modern në kohë moderne, por dhe me kushtet politiko-sociale në të cilat jetonin , të cilat i detyronin që për t’u shprehur të gjenin rrugë dhe mjete të reja . Në studimet e kritikëve tanë letrarë , sidomos të Ali Aliut , Sabri Hamitit , Agim Vinçës e Floresha Dados, dekadat e fundit ky problem është këndvështruar më thellësisht duke e pranuar një si fenomen letrar që i ka rrënjët në vitet ’30-’40 në letërsinë shqipe. Arsyeja se përse është lënë në heshtje ka qenë anatemi dhe censurimi i letërsisë që për shkak të hermetizmit, mjaft vepra të autorëve janë ndaluar dhe autorët vetë janë anatemuar. Për këtë arsye mjaft artikuj që janë botuar në revistën “Drita”, “Nëntori” e në shtypin e kohës , kanë marrë kritika të ashpra e janë ripunuar e transformuar.

RIPRODHIMI ARTIFICIAL

Andi Bërdëllima

Departamenti i Drejtësisë

Fakulteti i Shkencave Humane

Universiteti Ismail Qemali Vlorë

andiberdellima@gmail.com

Abstrakt

E ardhme e frikshme apo premtuese (eugjenizmi).

Teknikat e riprodimit artificial kanë krijuar mundësinë për një numër të madh individësh steril dhe jo vetëm, të mund të riprodhohen dhe të ndiejnë kënaqësinë e prindërimit. Por zhvillimet e fundit të teknologjisë po nxjerrin në pah një tjetër etje të prindërve të ardhshëm, dëshirën për të korigjuar gjenetikisht fëmijët e tyre. Por a e ka të drejtën një prind i ardhshëm të vendosë mbi vlerën gjenetike të fëmijës së tij? A pritet të jetë 'optimizimi' shoqëror trendi i ri që do të ndiqet në përzgjedhjen e materialit gjenetik? Qëllimi i këtij punimi është të nxjerr në pah prirjet e reja të krijuara nga ndërhyrjet gjenetike në riprodhimin artificial. Punimi i jep rëndësi edhe analizimit të raportit midis individit si prind edhe shtetit. A është i detyruar shteti të ruajë individin nga vetvetja?

Fjalët kyçe: gjen, riprodhim artificial, eugenizmi, përzgjedhje, fëmijë.

BIRESIMI TRANSRACIAL

Anxhela Alliu

Fakulteti i Shkencave Humane
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
alliu anxhela@yahoo.com

Abstrakt

Në këtë temë diskutohet rreth biresimit transracial e cila është një nga temat më specifike rreth këtij formë biresimi. Vecantia e këtij biresimi na bën në më shumë kurioz për të vëzhguar dhe argumentuar më hollësi çdo detaj për biresimin transracial. Në këtë temë do të përfshihen këto pika kryesore: 1- është biresimi transracial; 2-biresimi transracial, avantazhet dhe disavantazhet; 3-përshtatja e fëmijes me familjen e re; 4-rast të biresimit transracial, 5-Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijes . Mendoj se kjo do të jetë një nga temat më të përshtatshme për këtë konferencë pasi lidhet më një çështje tepër të rëndësishme dhe tërheqëse.

Fjalë kyçe: biresim transracial, interesi më i lartë i fëmijes

CENSURA NË FOKUSIN E PRONËSISË INTELEKTUALE

Dea Nini

Departamenti i Drejtësisë
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
deanini97@gmail.com

Abstrakt

Objekti i kësaj kumtese lidhet me aspekte të fenomenit "censurë" në kuadër të të drejtave të autorit si një dukuri e ndeshur gjerë në botë. Arsyeja e kësaj sipërmarrjeje lidhet me pjesëmarrjen në një

konferencë studentore multidisiplinare. Ndonëse koncepti "censurë" ka ngjallur mjaft diskutim ndër kohëra, rregullimi ligjor i tij lë vend për studime më të thelluara e më të detajuara. Ky fakt shpjegon edhe qasjen tonë për të sjellë një këndvështrim interesant në kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar lidhur me çështjen në fjalë. Struktura e kësaj pune është konceptuar e ndarë në tri krerë, pjesën hyrëse, konkluzionet dhe rekomandimet si dhe literaturën mbështetëse. Pjesa hyrëse trajton censurën në një fokus kronologjik, qysh nga shfaqjet e formave të para. Në kreun e parë shpjegohet kuptimi i censurës dhe llojet e saj; në të dytin shihet koncepti brenda kornizave të legjislacionit shqiptar; në kreun e tretë sillen disa fakte mbi ideologjinë si një "censurë" brenda censurës" në veprat e realitetit komunist. Kreu i katërt na përqsas me një panoramë të realitetit amerikan lidhur me fenomenin, pasuruar edhe me vendime gjyqësore. Për të finalizuar kumtesën tonë na është dashur të hulumtojmë dhe të studiojmë një korpus të larmishëm informacioni që përfshin tekste teorike në gjuhën shqipe, angleze dhe italiane, ëeb-faqe zyrtare, doktrinë si dhe libra elektronikë. Metodologjia e përdorur në këtë punim është ajo përshkruese, krahasuese dhe analizuese. Rastet e censuruara shpesh rrezikojnë të pengojnë të drejtat e lirisë së dramaturgëve, skenaristëve, krijuesve të filmave, interpretuesve dhe shpërndarësve. Hendeku mes botës së hershme dhe tonës, qëndron në statusin e individualitetit të secilit, që i përket ekskluzivisht një bote moderne dhe ku censura duhet të jetë tejet e kontrolluar në mënyrë që individualiteti të ruhet.

Fjalë kyçe: censurë, individualitet, transformim ideologjik, kuadër ligjor, Index Librorum Prohibitorum

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE. A NA MUNDËSON KUADRI LIGJOR SIGURINË E NEVOJSHME?

Dea Nini

Departamenti i Drejtësisë
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
deanini97@gmail.com

Abstrakt

Procesi i globalizimit dhe digjitalizimi kanë ofruar për shoqërinë njerëzore benefite me vlerë në çdo aspekt të jetës. Nga ana tjetër, sfidat me të cilat përballemi janë të shumta e po kështu vakumet ligjore lidhur me to. Mes kësaj kumtese kemi patur si synim një qasje të posaçme ndaj një koncepti aktual, që në kohë të ndryshme ka patur impakt të ndryshëm. Objekti i këtij punimi lidhet me një këndvështrim mbi nivelin e mbrojtjes së të dhënave personale. A na mundëson kuadri ligjor sigurinë e nevojshme? Ky punim realizohet në kuadër të një konference studentore me synimin për t'u thelluar në një hulumtim edhe më të gjerë e profesional në të ardhmen. Platforma e kësaj kumtese përfshin pjesën

hyrëse, atë mbyllëse dhe zhvillimore, e cila është konceptuar e ndarë në katër krerë. Çështjet e parashtruara trajtojnë aspekte interpretative të kuadrit të brendshëm juridik lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale e atyre sensitive, të drejtat e subjekteve të procesit të përpunimit, një panoramë sintetike ndërkombëtare me në fokus aktet me më tepër ndikim në këtë fushë. Po kështu, trajtohet "The Internet of things", një koncept tepër interesant që i atribuohet ekskluzivisht zhvillimit të teknologjisë dhe riskut të rritur për abuzim me të dhënat tona personale si dhe elementet e identifikimit, verifikimit dhe kodimit si një kundërpërgjigje. Së fundmi, trajtohen pesë çështje të jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut që ravijëzojnë qëndrime unike të saj. Qasja jonë konsiston në sensibilizimin mbi rëndësinë aktuale të kësaj teme, duke nënvizuar rëndësinë që ka siguria në cilësinë e jetës së njeriut që progreson në raport me zhvillimet e kohës dhe nevojën e vendosjes së një standardi më të qëndrueshëm për praktikatat e shteteve kombëtare lidhur me konceptin në fjalë.

Fjalë kyçe: të dhëna personale, të dhëna sensitive, siguri, privatësi, Internet of things, legjislacion

ROLI I KONVENTES EUROPIANE TË DREJTAVE TË NJERIUT NË RENDIN JURIDIK SHQIPTAR

Dorisa Ruda

Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"
Fakulteti Ekonomik
Departamenti i së Drejtes
Dega Shkenca Juridike në Administratën Publike
Theodoraruda@gmail.com

Abstrakt

Dispozitat Kryesore Kushtetuese ashtu sikurse dhe Kushtetuta e vitit 1998, nuk bene gjë tjetër, vecse afirmuan, sanskionuan dhe siguruan të drejtat themelore të njeriut. Këtë afirmim e fuqizoj akoma më teper, ratifikimi nga ana e shtetit Shqiptar, i Konventes Europiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo Konvente është një nga garancitë më të rëndësishme, që, në mënyrë të qartë përcakton të drejtat por dhe kufizimet që mund t'u vendosen të drejtave. Në këtë mënyrë ajo luan një rol kyç në garantimin e këtyre të drejtave. Kete garantim dhe zgjidhjen e konflikteve që mund të lindin e bën Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Neëe do të na nevojtej të ndërtojmë një raport krahasimi, natyrshem do të mund të themi që nëse Konventa është një Kushtëutë e mirefilltë të drejtash, atëhere kjo Gjykatë ka një pozitë të barazvlefshme me Gjykatën Kushtetuese, por shumë herë edhe superioriteti.

Ratifikimi i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mund dhe duhet të konsiderohet si një nga aspektet që ka sjellë ndryshime por gjithashtu edhe përmirësimin e rendit juridik Shqipëtar dhe në

këtë mënyrë, Shqipëria vendoset përpara pasqyres duke e pare veten jo vetem si shtet i së drejtës edhe si një shtet social.

Më ane të këtij punimi, fillimisht, do të trajtohet në mënyrë të përbledhur historia e shtetit Shqiptar në aderimin e Këshillit të Europës, si dhe do të trajtohet në mënyrë të vecantë momenti i ratifikimit të Konventes nga ana e shtetit tonë ashtu sikurse dhe ndryshimet që ky ratifikim solli në rendin juridik të brendshëm, pa harruar parashikimet kushtetuese në kuader të vleresimit dhe rëndësisë që Kushtetuta i jep kësaj Konvente. Në mënyrë që një gjë e tillë të arrihet, do të përdoret jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nga e cila është lehtësisht i kuptueshëm vendi i KEDNJ dhe roli i GJEDNJ.

Fjalë kyce; Konventa Europiane të drejtave të Njeriut, Gjykata europiane të Drejtave të Njeriut, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, rol, rendi juridik Shqiptar

ZHVILLIME TË SË DREJTËS SË MJEDISIT NË VËSHTRIM KRAHASUES, BASHKIMI EUROPIAN DHE NË SHQIPËRI

Elba Arapi

Udhëheqëse: Prof. Iris PETRELA
arapi_elba@yahoo.com

Abstrakti

Ky punim është realizuar në një analizë të hollësishme të së drejtës së mjedisit në përgjithësi, duke marrë në analizë krahasuese aktorë të ndryshëm që ndikojnë në mjedis. Analizohet e drejta e mjedisit në Bashkimin Europian si dhe ndikimi i tyre në të drejtën e mjedisit në Shqipëri dhe në gjëndjen aktuale të mjedisit. Nga ky punim synohet të njiheni me legjislacione të ndryshme të së drejtës së mjedisit dhe rrugën në të cilën është dukë përshkruar e drejta e mjedisit në Shqipëri.

Pyetjet kërkimore që kanë orientuar këtë punim janë

Çfarë do të kuptojmë me termin mjedis? Çfarë përfshin e drejta e mjedisit? Si kanë evoluar e drejta e mjedisit? Cili ka qënë roli i aktorëve të ndryshëm shtetëror dhe ndërshtetëror në të drejtën e mjedisit? Cilat janë normat e së drejtës së bashkimit europian në lidhje me të drejtën e mjedisit? Si janë reflektuar këto norma në kuadrin ligjor shqiptar? A mund të themi Shqipëria është në rrugën e duhur për sa i përket standarteve të mjedisit?

Metodologjia

Metodologjia e përdorur në këtë studim konsiston në kërkimin shkencor të zbatuara gjerësisht në hulumtimet e shkencave shoqërore, të tilla si: metoda përshkruese, metoda krahasimore, metoda analitike dhe ajo interpretuese. Një pjesë e rëndësishme e punimit është edhe vështrimi krahasues me legjislacionin mjedisorë të disa shteteve dhe organizatave të ndryshme.

Hyrje

Ky punim është i ndarë kapituj që trajtojnë : Mjedisi dhe zhvillimi historik i së drejtës së mjedisit, Mjedisi në kendvështrim krahasues ndërmjet e aktoreve të ndryshëm shtetëror dhe ndërshtetëror, Shqipëria në rrugën e integritimit European, përafrimi i legjislacionit mjedisor shqiptare me atë të BE-së Gjendja aktuale e mjedisit në Shqipëri. Në fund, punimi mbyllet me konkluzionet, ku bëhet një përmbledhje e analizës së kryer përgjatë punimit, për të arritur zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës mjedisore në Shqipëri, për të pasur një Shqipëri të pastër për një jetë me të mirë.

Fjalë kyç: mjedis, aktorët mjedisore, përafrimi i legjislacionit të BE , mjedisit shqipëtar

VENDIMET E PUSHIMIT NË FAZEN E HETIMVE PARAPRAKE. STANDARTE TË ARRITURA DHE PROBLEME TË REZULTUARA NGA PRAKTIKA. KUADRI KUSHTETUES DHE NDËRKOMBËTAR

Msc. Eni Grykshi

Universiteti Tiranes

Fakulteti Drejtesise

Master Shkencor Penal

Email. Nick_eni@hotmail.com

Abstrakt

Prokuroria në Republikën e Shqipërisë është një organ kushtetues i pavarur me kompetenca tepër të rëndësishme, përse i përket ushtrimit të ndjekjes penale dhe hetimeve paraprake. Krahas këtyre kompetencave që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka atribuar organit të akuzës, Kodi i Procedurës Penale i ka njohur një kompetencë tepër e rëndësishme, të drejtën për të mos filluar apo për të pushuar procedimin penal. E drejta për të pushuar procedimin penal, është konsideruar një kompetencë ekstra që i eshte dhene prokurorit, që nuk është në përputhje me funksionet që organi i akuzës ka sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, një e drejtë që i jep prokurorit funksione që kanë të bëjnë me dhënien e drejtësisë, që është funksion eksklusiv vetëm i gjykatave. Për këtë arsye neni 328 i Kodit të Procedurës Penale, u bë objekt i shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese, për të deklaruar nenin e mësipërm si të papajtueshëm me nenin 148/1 të Kushtetutës e Republikës së Shqipërisë. Gjykata Kushtetuese, u shpreh në lidhje me këtë kërkesë dhe e deklaroi nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (me nenin 148 të saj).

Fakti që kjo e drejtë, njohur prokurorit u bë temë e një debati të gjerë duke përfshirë edhe Gjykatën

Kushtetuese, si dhe fakti që kjo është një e drejtë tepër e rëndësishme që i është njohur prokurorit në Republikën e Shqipërisë, (në shumë vende si Italia apo Franca me eksperiencë shumëvjeçare dhe të konsoliduar përsa u përket të gjitha hallkave që lidhen me sistemin e drejtësisë, prokurorit nuk i atribuohet ky funksion), kjo beri që une të zgjedh dhe të trajtoj si temë *“Vendimet e pushimit në fazën e hetimeve paraprake. Standarde të arritura dhe probleme të rezultuara nga praktika. Kuadri kushtetues dhe ndërkombëtar”*, për punimin që studentët e vitit të dytë të Masterit Shkencor, duhet të paraqesin.

E DREJTA PËR TË JETUAR NË LIDHJE ME TË MITURIN

Enea Basho

Paula Kapaj

Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë

Departamenti i Drejtësisë

Master profesional

enea94@hotmail.com

Abstrakti

Mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gëzon një mbrojtje të njëjlojtë për çdo shtetas. Mbrojtje absolute gëzon dhe e drejta për të jetuar e cila është pjesë e këtyre të drejtave. Jeta e personit mbrohet me ligjin kushtetues si dhe një sërë konventash ndërkombëtare. Kjo e drejtë është e pandashme, e patjetërsueshme, edhe pse është e njëjlojtë për çdo person merr një dimension tjetër kur bëhet fjalë për një kategori të veçantë siç janë të miturit. Jeta është një e drejtë, atribut fundamental i qenies njerëzore dhe kur kjo jetë hiqet, apo merret në çfarëdolloj mënyre, njeriu në të njëjtën kohë eliminohet si mbartës të drejtash dhe detyrimesh. Sot në botë ka një diskutim madhor për abortin dhe eutanazinë nëse klasifikohet vrasje apo jo. Pyetja që i shtroj vetes është se, a ndodhen të pregatitur dhe a ndihen komod shteti dhe shoqëria shqiptare në përgjithësi përballë një legjislacioni të tillë emancipues e modern dhe a janë ato në gjendje që të garantojnë jetën e personit, lirinë dhe sigurinë e tij, ndërkohë që kanuni, rregullat zakonore, vetëgjyqësia dhe gjakmarrja arrijnë të eklipsojnë ligjin? Këto fenomene që vazhdojnë të egzistojnë dhe pse nuk janë derivate të ligjit gjithmonë e më tepër po dëmtojnë fëmijet, si pjesa më e brishtë dhe e pambrojtur e shoqërisë.

Fjalë kyce: jeta, e drejtë, liri, eutanazia, aborti, i mituri.

EFEKTI VAZHDUES I DHUNËS NË FAMILJE MIDIS ISH-BASHËSHORTËVE

Zalika Gjomemetaj

Olsandra Alinikaj

Fakulteti i Shkencave Humane
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
zalikagjomemetaj4@gmail.com

Abstrakt

Vitet e fundit në Shqipëri, është rritur ndjeshëm numri i zgjidhjeve martesore apo edhe i rasteve të dhunës në familje. Në të shumtat e rasteve viktimat e dhunës janë gratë dhe fëmijë. Për të zbuluar rrënjët e egzistencës së këtij fenomeni, vlen të analizohet në kohë rëndësia e gruas në shoqëri.

Qëllimi i këtij punimi është të analizoj në kohë fenomenin, duke shpjeguar format e dhunës, dhe shkaqet që përcaktojnë vazhdimësinë e saj. Kuptimi i formave të dhunës dhe pasojat e saj, do të vijë bazuar në një analizë krahasimi, dhe interpretimi të legjislacionit. Duke patur parasysh se ka një raport varësie midis viktimës dhe dhunuesit është me rëndësi të analizohet edhe roli i shtetit, si rregullator në këtë marrëdhënie.

Fjalët kyçe: Dhunuesi, Viktima, Dhuna fizike dhe psikologjike, Urdhër i menjëhershëm mbrojtje, Urdhër mbrojtje

FIRMAT PIRAMIDALE NË SHQIPËRI DHE QËNDRIMI I FONDIT MONETAR NDËRKOMBETAR

Azis Jata (Doktorant)

Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë
Departamenti i Historisë
azisjata@yahoo.com

Abstrakt

Ekonomia shqiptare në fillimin e viteve 90 përshkruhet si një sektor i madh informal ku ka mangësi qeverisje dhe njohurish, vështirësi në mbledhjen e taksave, shërbime të varfra publike, të ardhura të ulëta dhe shpenzime të ulëta, të gjitha këto e kthejnë në një cikël vicioz me shumë pasoja. Padyshim të gjitha këto arsye e bënin Shqipërinë një vend vunerabël dhe të hapur ndaj gjërave të panjohura e negative në demokraci.

Gjithashtu zhvillimi i dobët i shërbimeve, si pasojë e mospërfilljes së infrastrukturës në përgjithësi (fizike, sociale dhe tregëtare), është i lidhur me këto pabarazi dhe ka një efekt negativ në produktivitetin e ekonomisë si të tërë.

Dështimi për të krijuar një infrastrukturë të vazhdueshme ka qënë një hendek i madh sasior për ekonominë shqiptare ndër vite; është e pamundur të shprehen efektet negative në termin sasior.

Mungesa e kapacitetit të transportit dhe telekomunikacionit të varfër janë ndër faktorët më të rëndësishëm. Më të padukshmet por jo më të parëndësishmet ishin mangësia në shërbimin e informacionit, lidhjet tregëtare dhe shërbimeve të tjera të specializuara.

Edhe pse kalimi i Shqipërisë në një ekonomi tregu ishte i shpejtë dhe mjaft i suksesshëm, reforma e sektorit financiar ishte shumë e kufizuar. Sistemi financiar formal i Shqipërisë ishte fillestar. Ka pasur disa banka. Banka e Shqipërisë u krijua si bankë e nivelit të parë dhe ishte banka qendrore e vendit, ndërkohë që tri banka të tjera shtetërore: Banka e Kursimeve, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Tregtare Agrare, përbënin nivelin e dytë të sistemit bankar. Banka e Kursimeve ishte pasardhëse e Institutit të Kursimit me një status të ri si një bankë universale. Banka Kombëtare Tregtare ishte një shkrirje e aktivitetit tregtar të brendshëm të Bankës së Shtetit Shqiptar me Bankën Tregtare Shqiptare. FMN dhe Banka botërore ishin të alarmuar nga situata e krijuar nga firmat piramidale dhe kerkuan marrjen e masave drastike për ndërprerjen e këtij fenomeni.

Fusha e studimit: Marrëdhënie Nderkombëtare

NDRYSHIMET MES KISHËS PROTESTANTE LUTERANE DHE KISHËS KATOLIKE

Bertina Salliu

Universiteti I Tiranës Fakulteti Histori-Filologji
Departamenti I Historisë
Master Shkencor-Histori
bertinasalliu@gmail.com

Abstrakt

Punimi titullohet "Ndryshimet mes Kishës Protestante luterane dhe Kishës Katolike." E përzgjedhëm këtë temë pasi Kishat Protestante luterane kanë gjetur një përhapje të gjerë në ditët e sotme paralel me Kishat Katolike. Nisur nga ajo çka është vërejtur në rrjedhat e historisë ka pasur një rivalitet dhe një ndryshim që vazhdon të jetë i dukshëm edhe kohët e fundit. Duke qënë se jemi edhe në një përvjetor të rëndësishëm, pikërisht në 500-vjetorin e Reformacionit Protestant me nismëtar murgun gjerman Martin Luther menduam se trajtimi i kësaj teme gjen vend për të theksuar veprën e tij sot.

Një arsye tjetër e këtij punimi është dhe fakti se në numrin e shumë të këtyre Kishave Protestante luterane dhe Kishave Katolike është shumë i theksuar ndryshimi doktrinal. Siç të gjithë e dimë historia nuk është gjë tjetër veçse studimi i së shkuarës së njerëzimit për ndërtimin e së ardhmes, në këtë mënyrë studimi i këtij ndryshimi na bën të reflektojmë mbi vlerën e veprës luterane. Synojmë që të tregojmë se kjo nuk ishte një veprë që ndodhi vetëm në shek. XVI, por është e gjallë sot në vitin

2017 nëpërmjet Kishave ekzistente në shumë qytete si në Europën Perëndimore, Amerikë, edhe në Europën Juglindore. Kjo dokumentohet edhe nga shumë aktivitete të ndërmarra në këtë kohë si Konferenca Ndërballkanike e organizuar në Shkup më 5-8 tetor.

Përsa i përket strukturës punimi është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë kemi trajtuar gjerësisht ndryshimet mes dy Kishave në aspektin fetar dhe të organizimit dhe drejtimit të tyre. Në pjesën e dytë kemi dhënë rëndësinë e evidentimit të këtyre ndryshimeve dhe dukshmërinë e tyre sot nisur nga të dhënat historike në ndërthurje me rezultatin që ne kemi konstatuar.

Për realizimin e këtij punimi kemi përdorur një literaturë të gjerë në gjuhën shqipe dhe kryesisht anglisht, pasi autorët e huaj i kanë dhënë vëmendje këtij hendeku mes Kishave. Ndër autorët e huaj jemi përpjekur që të përdorim botimet e tyre akademike duke respektuar tezat e tyre të mirëargumentuara dhe për të qëndruar besnikë në ndarjen e historisë nga teologjia. Ndër këta autorë përmendim Milton Viorst, *The great document of Eastern Civilization* 1967; Mounir Farah, Andrea B. Karls & Carl Kortepeter, *A World History* 1985; Kenneth S. Latourette, *A History of Christianity* 1997 etj. Ndër tekstet universitare në gjuhën shqipe përmendim: Agron Gani, Gëzim Sala & Hysen Shabanaj, *Historia e Europës* 2001; Andi Pinari & Llambro Filo, *Historia e Europës dhe SHBA-së në Periudhën e hershme Moderne* 2007; Ermal Baze, *Cikël leksionesh* 2016-2017 etj.

Fjalë kyçe: Kisha Protestante luterane; Kisha Katolike; Papati; doktrina qendrore; sakramentet; Shkrimi i Shenjtë etj

MIGRIMI DHE EFEKTET EKONOMIKE, RASTI I SHQIPËRISË

Dashnor Klllogjri

Master Shkencor

Universiteti i Tiranës, Fakulteti Historisë dhe Filologjisë

dklllogjri107@gmail.com

Abstrakt

Migrimi është një dukuri shumë dimensionale që ka ndikime të ndryshme ekonomike, shoqërore dhe mjedisore për vendet e destinacionit dhe të origjinës. Shqipëria u përfshi në mënyrë intensive nga proceset migrative në fillim të viteve 1990. Tashmë shkaqet dhe faktorët janë të njohura dhe të analizuara në mënyrë të detajuar. Ato lidhen ngushtësisht me faktorët ekonomik të trashëgimisë së ekonomisë së centralizuar duke bashkëpunuar në mënyrë të menjëhershme me faktorët politik, izolimi shumëvjeçar dhe largimi nga demokracia reale. Emigracioni ka luajtur një rol të rëndësishëm në zbutjen e papunësisë dhe të varferisë përgjatë viteve të vështira të tranzicionit. Emigracioni dhe remitancat kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e mirëqënies materiale. Dërgesat e emigrantëve

shqiptarë kanë ndikuar në dhënien e një ndihme ekonomike të vlefshme jo vetëm për familjet e tyre, por edhe për stabilizimin socio-ekonomike të vendit në teresi. Qëllimi i këtij punim është të shpjegojë rolin pozitiv të remitancave, si burim i rëndësishëm i rritjes financiare dhe zhvillimit ekonomik të vendit, duke siguruar në vazhdim qasje në monedhë të huaj në Shqipëri, si dhe duke konsoliduar bazën për kursime dhe investime. Ky punim evidenton një pasqyrë të rëndësishme të ndikimit të remitancave në ekonominë e Shqipërisë deri në kohët e sotme. Gjithashtu paraqitet një dinamikë e remitancave të emigrantëve në zhvillimin e vendit. Për realizimin e punimit është përdorur metoda statistikore-matematikore që i kanë shërbyer analizave të problemeve sasiore, vlerësimeve cilësore dhe vlerësimeve të prognozës të aspekteve të ndryshme, me synim për paraqitjen sa më konkrete remitancat e emigracionit në Shqipëri. Punimi përfundon me dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

Fjalët kyçe: Emigrim, remitanca, ekonomi, zhvillim, papunësi.

GJURMIME ARKEOLOGJIKE NË ZONËN E PËRROIT TË KUSHËS NË RRETHINAT E ELBASANIT

Elvis Sllami

Universiteti "A. Xhuvani"

Elbasan

elvis-sllami@live.com

Abstrakt

Ky punim është një pjesë nga tema e paraqitur për mbrojtjen e diplomës në përfundim të studimeve të nivelit bachelor në degën histori-geografi pranë Universitetit "A. Xhuvani" Elbasan, udhëhequr nga arkeologu Prof. as. dr. Ylli Cerova. Këtu synohet të paraqiten në mënyrë të përmbledhur të dhënat arkeologjike dhe historike nga trevat mbi përroin e Kushës, të cilat ndahen në 3 njësi administrative të bashkisë së Elbasanit.

Fillimisht është punuar që të mblidhen e të sistemohen të dhënat që vijnë nga vëzhgime të mëparshme sporadike të arkeologëve e historianëve tanë, por edhe atyre të huaj, dhe, ç'është më e rëndësishmja, informacioni shtohet nga grumbullimi, paraqitja dhe interpretimi i të dhënave të reja që ka sjellë kërkimi ynë në terren.

Duhet të theksojmë se kërkimi në terren është drejtuar nga të dhënat gjuhësore. Paraprakisht është vjelë dhe është studiuar sistemi mikrotoponimik i zonës dhe më pas është bërë gjurmimi dhe identifikimi i pikave ku mund të gjendeshin objektet me interes arkeologjik e historik.

Në objektivin tonë kanë qenë vendbanimet a fortifikimet e hershme, që lidhen me toponimin "Qytezë", objektet e kultit, që lidhen me toponimin "Kishë" ose me një emër shenjtori, si edhe elementë të infrastrukturës së hershme që i lidhin këto.

Kur ka qenë e mundur është bërë përpjekje për të vendosur edhe një rend kronologjik të objekteve të identifikuara.

Fusha studimit: arkeologji

Fjalë kyçe: toponim, fortifikim, sistem rrugor, objekt kulturi

TIPARET E MIGRIMIT AKTUAL NË SHQIPËRI

Erind Drita

Fatjon Bebja

Ndue Prela

Master Shkencor

Universiteti i Tiranës

Fakulteti Historisë dhe Filologjisë

fatjon.bebja@hotmail.com

Abstrakt

Migrimi nuk është një fenomen i ri, por e ka shoqëruar zhvillimin e shoqërisë njerëzore gjatë gjithë historisë së saj. Ai ka lindur bashkë me shoqërinë njerëzore, është i lashtë po aq sa ajo, dhe e ka shoqëruar njeriun në çdo hap të evolucionit të tij. Lëvizja e njerëzve nga një vend në një tjetër ka ndikuar në zhvillimin e kulturave të ndryshme nga njëra anë si dhe në shkëmbimet e tipareve kulturore nga ana tjetër; nëpërmjet komunikimit apo përzgjedhjes së njerëzve dhe kulturave të tyre përkatëse nga vende të ndryshme të botës. Studimi i migrimit shqiptar, veçanërisht atij ndërkombëtar, kërkon një interpretim të veçantë për shkak të vetë karakterit shumë dinamik dhe intensive të tij. Madje Shqipëria konsiderohet si një lloj laborator për të studiuar proceset e reja migruese, sidomos për masën e emigracionit bashkëkohor të saj dhe migrimin e brendshëm si dhe ndërlidhjen në mes dy llojeve të lëvizjeve.

Qëllimi i këtij punim është paraqitja e tipareve të migrimit aktual në Shqipëri, duke evindetuar flukset migratore në vitet e fundit në Shqipëri. Ky punim trajton historinë e migrimit në Shqipëri, flukset migratore aktuale, faktorët dhe motivet e lëvizjeve migruese, rrugët kryesore të emigrimit të parregullt, efektet dhe pasojat sociale të migrimit.

Për realizimin e punimit është përdorur metoda e shfrytëzimit të literaturës kryesisht gjeografike, statistikore, sitemimi dhe përpunimi i të dhënave, me synim për paraqitjen sa më konkrete tiparet e migrimit aktual në Shqipëri.

Punimi përfundon me dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve për të ndërmarrë politikat integruese për përballimin e lëvizjeve migratore.

Fjalë kyçe: Migrim, fluks migratore, migrim i parregull, rrugët emigrimit, efektet dhe pasojat e migrimit

KËRKIME ARKEOLOGJIKE NË ZONËN E BISHQEMIT, RRETHI I PEQINIT

Ervis Kasa

Universiteti "A. Xhuvani"

Elbasan

Ervis_Kasa@Yahoo.Com

Abstrakt

Zbulimet arkeologjike janë gjithmonë të një vëmendjeje dhe rëndësie të veçantë për arkeologët, historianët, gjuhëtarët, por edhe më gjerë. Nxitur nga ky fakt Universiteti "Aleksandër Xhuvani", në kuadër të organizimit të punës për kërkimin shkencor, falë bashkëpunimit të departamenteve të histori-geografisë, të gjuhësisë dhe QSAB-së (Qendra e Studimeve Albanologjike e Ballkanologjike), ndërmori një projekt ambicioz për kërkime arkeologjike dhe gjuhësore në luginën e mesme të lumit Shkumbin.

Një nga zonat e studimit në këtë projekt është ajo e Bishqemit. e cila gjendet në krahun lindor të rrethit të Peqinit. Në jug kufizohet nga lumi Shkumbin, ndërsa në veri relievin fushor e zëvendëson sektori kodrinor Bishqem-Vrap-Fortuzaj, i kodrave të Kërrabës.

Studimi i kësaj zone nisi nëpërmjet ekspeditave përnjohëse në terren dhe më pas u kryen sondazhe arkeologjike. Kronologjikisht, gjurmët e jetesës në këtë zonë kanë filluar në shek. IV-III p.e.s me fortifikimin e Saragut dhe tempullin pagan të Heliosi-t (Diellit). Më pas, periudha romake ruan gjurmët nëpërmjet qeramikës dhe Via Egnatia-s. Ndihmë të veçantë për evidentimin e monumenteve arkeologjike, si p.sh., kisha, tempull, vendbanime, rrugë etj., e ka dhënë toponimia. Më konkretisht, nëpërmjet toponimit "Shndreza" u zbulua kisha e Shën Andrea-s dhe vendbanimi tarracor mesjetar ku edhe u përqendruan sondazhet arkeologjike. Bashkëpunimi midis arkeologjisë dhe gjuhësisë duket se po bëhet më i nevojshëm dhe kjo risi po shkon drejt suksesit.

Rezultatet e sondazheve arkeologjike në kishën e Shën Andrea-s, Shën Mërisë dhe fortifikimit pranë tyre shfaqin interes të veçantë për çështjen e vazhdimësisë iliro-arbërore. Larmia e artefakteve arkeologjike japin të dhëna për zhvillimin kompleks të jetës në këtë zonë. Gërmimet janë kryer nga studentët Ervis Kasa, Miklevan Deliu dhe Elvis Sllami

Fusha studimit: arkeologji

Fjalë kyçe: fortifikim, artefakte, objekte kulti, vendbanim, rrjet rrugor, toponimi

FAN NOLISIPAS HISTORIOGRAFISË SHQIPTARE TË PERIUDHËS SË KOMUNIZMIT

Msc. Kosovar Alija

Msc. Artan Reshani

Universitetin i Prishtinës "Hasan Prishtina"

Fakulteti Filozofik

kosovaralija2013@gmail.com

artan.r@hotmail.com

Abstrakt

Fan Stilian Noli padyshim është një nga figurat më të shquara dhe më erudite që ka historia e Shqipërisë, dhe si i tillë ka zgjuar interesimin e shumë studiuesve të historisë, për ta trajtuar në suaza shkencore këtë figurë kombëtare. Ky punim do të trajtojë, figurën e veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare Fan. S. Nolit, në historiografinë shqiptarë të periudhës së komunizmit. Do të përpiqemi të sjellim vlerësimet për rolin Nolit në histori, të bazuar në studimet që kanë bërë shumë historian. Noli në historinë shqiptare ka qenë objekt diskutimi për shumë vitetë qarqet studiuese shqiptare, ku historian të shumtë kanë sjell përfundime nga më të ndryshmet për këtë figurë të rëndësishme kombëtare. Pjesa më emadhe edebatit, në kuadër të rolit të Fan Nolit në historinë kombëtare, bëhet për Revolucionin e Qershorit të 1924.

Historiografia komuniste shqiptare, pavarësisht se është e gjerë, ajo është e njëanshme. Historianët marksistë u përpoqën ta shfrytëzonin figurën e Nolit për qëllime politike dhe nuk paraqitën kurrë një qëndrim kritik. Literatura e krijuar në Shqipëri në vitet e komunizmit është e politizuar, e prirë drejt një pikëpamjeje bardhezi. Gjithashtu ky punimi, jep informacione për figurën e Fan S. Nolit, ngjarjet e rëndësishme historike në të cilat u përfshi ai, duke ju qasur kontekstit historiografik, që është edhe bosht i punimit.

Fusha e studimit: Histori

Fjalë kyçe: Noli, historiografia komuniste, revolucionin i qershorit, lidhja e kombeve, periudha e komunizmit

KËRKIME ARKEOLOGJIKE NË ZONËN E FUNARIT, RRETHI I ELBASANIT

Miklevan Deliu

Universiteti "A. Xhuvani"

Elbasan

miklevandeliu@yahoo.com

Abstrakt

Janë të një rëndësie të veçantë kërkimet e integruara në fushën e arkeologjisë, historisë dhe gjuhësisë. Me këtë qëllim Universiteti "Aleksandër Xhuvani" në sajë të bashkëpunimit të departamentit të histori-gjeografisë, të gjuhësisë dhe të QSAB (Qendra e Studimeve Albanologjike dhe Ballkanologjike), ka nisur një kërkim shkencor ndërdisiplinar në luginën e mesme të Shkumbinit. Projekti parashikon që puna kërkimore të kryhet nga studentët.

Pjesë e projekteve është edhe kërkimi në zonën e Funarit, e cila ndodhet në rrethinat e Elbasanit, pothuajse në veri të qytetit.

Krahina e Funarit kufizohet në lindje nga përroi i Zaranikës, në veri nga degët e majta të lumit Erzen, në perëndim nga përroi i Kushës dhe në jug nga lugina e lumit Shkumbin.

Studimet arkeologjike në këtë zonë kanë qenë të pakta. Kjo është një nga arsytet që u ndërmor ky studim dyvjeçar. Studimi konsiston në evidentimin e vendbanimeve të hershme kristiane bazuar në mikrotoponimi dhe në gjurmët arkeologjike. Sondazhet arkeologjike u përqendruan në kishën mesjetare që u evidentua në vendbanimin e fortifikuar në Shkëmbin e Letanit. Pikërisht mbi lartësinë e shkëmbit ndodhet fortifikimi dhe pothuajse në majën më të lartë të tij ndodhet kisha e Shën Mërisë. Nga sondazhet arkeologjike të kryera në kishën mesjetare u përfituan planimetria e plotë e saj dhe materiali arkeologjik. Arkitektura e kishës na dëshmoi se kemi të bëjmë me një kishë peshkopale. Gërmimet janë kryer nga studentët Miklevan Deliu, Ervis Kasa dhe Elvis Sllami

Gjithashtu u evidentua dhe rruga antike që kalon përgjatë krahinës së Funarit dhe më tej në krahinën e Shën Gjergjit, për të vijuar drejt veriut, në Lissus dhe Scodra.

Fusha studimit: arkeologji

Fjalë kyçe: vendbanim, fortifikim, kishë peshkopale, rrjet rrugor, toponimi

TAKIMI I J. B. TITOS ME DELEGACIONIN SHQIPTAR NË BEOGRAD, 4 PRILL 1945

Mr.sc. SHEFQET DINAJ, Ph Dc

Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani"

Akademia e Studimeve Albanologjike- Shkencat Historike, Tiranë

shefqetdinaj@gmail.com

Abstrakt

Statusi politik-shoqëror i shqiptarëve të Kosovës në vitet (1945-1966), është një temë e rëndësishme për historinë e Kosovës dhe shqiptarëve, andaj, problematika që shqyrtohet dhe analizohet në këtë artikull, do të paraqesë një kontribut modest në avancimin e njohjeve të reja shkencore në kuadër të historiografisë shqiptare. Ky studim është një përpjekje për të kuptuar më mirë historinë e popullit shqiptar të Kosovës dhe trojeve tjera shqiptare në luftën për të drejtat njerëzore dhe kombëtare në Federatën Jugosllave. Përpjekje këto për të realizuar të drejtën e tyre të vetëvendosjes, shprehur në rrugë e forma të ndryshme, me programe politike të shkruara, me organizime të grupeve patriotike, me shpërndarje traktesh, me kërkesa për arsimim shqip, përdorimin e gjuhës shqipe në administratë, përdorimin e flamurit kombëtar, për fjalën e lirë etj. Përballë kësaj veprimtarie ka qëndruar dhuna politike, ushtarake dhe makinacionet juridike të pushtetit jugosllav. Objekt trajtimi në këtë studim është: Takimi i 4 prillit 1945 në mes të Delegacionit shqiptar dhe Mareshalit të Jugosllavisë J.B.Tito.

Fjalë kyçe: Statusi politik; Statusi shoqëror; Federata Jugosllave; Flamuri; traktet; , etj

KATALOGIMI INFORMATIK NË QENDRËN KOMBËTARE TË INVENTARIZIMIT TË PASURIVE KULTURORE

Aida Bojdani

Akademia e Studimeve Albanologjike

Shkolla e Doktoraturës dhe Masterit Shkencor "Arkeologji"

aidabojdani@yahoo.com

Abstrakt

Në këtë referim është paraqitur katalogimi informatik i objekteve arkeologjike në bazën e të dhënave të Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore (QKIPK). QKIPK është një institucion kombëtar, shkencor, që ka lindur si domosdoshmëri për krijimin e një baze të dhënash kompjuterike të rëndësishme të objekteve të trashëgimisë kulturore të Shqipërisë. Fokusi kryesor i temës së këtij referimi është katalogimi i objekteve arkeologjike në bazën e të dhënave të kësaj qendre. Kjo bazë të dhënash ruan dhe na jep një informacion të plotë mbi gjendjen e këtyre objekteve në një kohë reale të

shpejtë. Proceset e dokumentimit, inventarizimit, regjistrimit dhe katalogimit informatik do të trajtohen në këtë temë, si procese shumë të rëndësishme.

Do të paraqitet një historik i shkurtër mbi krijimin e kësaj qendre, puna për katalogimin informatik në bazën e të dhënave në këtë qendër, rëndësia e katalogimit të objekteve arkeologjike në institucionet përkatëse, që i posedojnë këto objekte dhe administrimi i tyre në Qendër. Gjithashtu lidhja e QKIPK me zyrën e doganave dhe ndihma që jep katalogimi informatik në këtë Qendër në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të trashëgimisë kulturore, janë të një rëndësie të madhe.

Fusha: Arkelogji

Fjalë kyç: bazë të dhënash, objekte arkeologjike, inventarizim, katalogim informatik, trashëgimi kulturore

EDUKIMI SPECIAL NË KOSOVË

Miranda Lushaj

mirandalushaj@hotmail.com

Universiteti i Prishtinës

Abstrakti

Objekti i këtij punimi është specifika e edukimit special në Kosovë. I cili nuk është problem i thjeshtë dhe jo shumë i studiuar. Pikërisht për këtë mund të themi që është problem kompleks, që kërkon një trajtim të kujdesshëm për t'u studiuar. Edukimi Special në Kosovë është një hap më shumë drejt inkluzionit dhe një hap i duhur i përfshirjes së drejtë dhe të barabartë të të gjithë nxënësve, gjë që më motivoj që t'i qasem kësaj teme. Përdorimi i termit "special" dhe gradimi i tij në "qendër burimore" është faze kyçe dhe me shumë interes që po na dërgon drejt një të ardhme më të mire dhe një gjithëpërfshirje më efektive e po ashtu fitimprurëse. Vetë problematika e kësaj fushe të studimit, e cila ende është temë e pa hulumtuara aq sa duhet deri më sot tek ne, më shtyri të njohem më për së afërmi me këtë problematikë, e cila mendoj se është me interes të diskutohet në këtë konferencë. Edhe pas më shumë se pesëmbëdhjetë vitesh edukimi special në shkollat tona nuk e ka trajtimin e duhur. Klasa special në shkollat tona nuk e kryen detyrën që ka, gjithëpërfshirjen e nxënësve në procesin e të nxënësit. Prandaj, së kendejmi edhe lind nevoja e trajtimit dhe e studimit të kësaj problematike.

Fusha e studimit: Edukimi inkluziv

Fjalët kyçe: Special, inkluziv, qendra burimore, gjithëpërfshirje.

MOTIVE SOCIALE TË DUHANPRIJES-FENOMEN SOCIAL I SHOQËRISË NJERËZORE

Tan Kazazi

Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë
Pedagogji/Sociologji
tan_kazazi@hotmail.com

Abstrakt

Duhani ka lidhje të forta me tipologjinë tradicionale të shoqërisë tonë. Kjo ka bërë që tradicionalisht të mos konsiderohet kurrë si "ves social". Madje fare pak ka qenë reagimi kulturor kundër duhanit edhe si dëm shëndetësor.

Duhani ka patur rolin e "lidhësit social" e kazusit social për njohjen e parë interpersonale midis njerëzve, që nuk njihen dhe që këtë element e kanë përdorur si shkak për njohjen fillestare. Këmbimi i duhanit në jetën tonë tradicionale ka qenë shenjë "besimi" për fillimin e njohjes dhe sinjal social që përdorej për zgjerimin e interkomunikimit personal. Parulla sociale "helmi del me helm" ka qenë lajtmotiv justifikues i pirjes së pandërprerë të duhanit nëpër vaki, raste fatkeqësish. Paradoksi është se ai është pirë edhe në festa, dasma e gëzime. Duhani është konsideruar si mjet çlodhës. Madje i shoqëruar edhe me kafe është konsideruar "ilaç" për të kapërcyer lodhjen fizike apo intelektuale.

Duhani është konsideruar si një nga shenjat e sigurta të burrërisë. Prandaj në të kaluarën ka qenë monopol vetëm për burrat. Madje edhe fillimi i duhanit në shoqërinë tonë ka nisur që nga fëmijëria (paradoksalisht pa shumë shqetësim familjar e social) e për të vazhduar me adoleshentët që e konsideronin duhanin (bashkë me pjekurinë seksuale) si shenjë të sigurt të rritjes.

Fjalë kyçe: Ves, vdekjeprurës, "shërues"

RËNDËSIA E PËRFSHIRJES SË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SISTEMIN ARSIMOR

Msc. Vituri Meta

marselameta@yahoo.com

Abstrakt

Vendi ynë sot është i përfaqësuar në arenën ndërkombëtare njëlloj si vendet e tjera, duke qenë kështu pjesë e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve. Përpjekjet e bëra për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse, janë rritur ndjeshëm, çështje kjo delikate si për shoqërinë dhe arsimin shqiptar.

Megjithatë nuk mund të themi se këto përpjekje, apo arritjet e deri tanishme janë të mjaftueshme, për të pasur një integrim të plotë të personave me aftësi të veçanta, e veçanërisht të fëmijëve me nevoja të veçanta edukative në shoqërinë shqiptare. Por cilët nxënës quhen me nevoja të veçanta edukative?

Nxënësit me nevoja të veçanta edukative, janë ata që kanë nevoja më specifike sesa nxënësit e tjerë, në kryerjen e funksioneve të jetës së përditshme, por edhe në të mësuar, të cilëve u nevojitet mbështetje për t'i kryer sa më mirë ato. Si rregull, të gjithë nxënësit kanë nevoja të ndryshme në të mësuar, në varësi të stileve të të mësuarit dhe të inteligjencës së shumëfishtë, por nxënësit me nevoja të veçanta edukative i kanë më të nevojshme këtë mbështetje dhe sidomos përfshirjen e tyre në sistemin arsimor, sepse përveç stileve të ndryshme të të mësuarit, nevojat e tyre mund ta kenë origjinën edhe në shkaqe që lidhen me dëmtimet fizike dhe njohëse, që ndikojnë në aftësinë për të mësuar.

Sipas statistikave të mbledhura nëpër shkolla të ndryshme për nxënësit me aftësi ndryshe, çrregullimet kryesore që hasen janë: Hiperaktiviteti, aftësi ndryshe intelektuale dhe autizmi. Aftësitë e këtyre fëmijëve për të nxënë janë të ndryshme dhe për këtë arsye nuk duhet synuar, që këtyre nxënësve tu jepet arsimim i barabartë, pra edukim i njëjtë me fëmijët e tjerë, por arsimim i drejtë prej të cilit nxënësit duhet të marrin edukim dhe të mbështetje, për të arritur rezultate të barabarta. Pra, nxënësve me nevoja të veçanta duhet t'u jepet mbështetje ekstra, që ata të kenë akses në të njëjtat mundësi si shokët e klasës, për tu integruar dhe socializuar në shoqëri.

Fusha: Edukim special

Fjalë kyçe: fëmijë me nevoja të veçanta edukative, arsimim i drejtë, arsimim i barabartë

ORGANIZIMI I KOPSHTEVE DHE SHKOLLAVE FILLORE NË QYTETIN E VLORËS PËR GJITHËPËRFSHIRJEN E FËMIJËVE AUTIKË

Alma Gusho

Universiteti "Ismail Qemali Vlore

Fakulteti i Shkencave Humane

Departamenti i Edukimit

ardiangusho@hotmail.com

Abstrakt

Vitet e fundit, në rrethanat kur fenomene si autizmi janë bërë pjesë e jetës dhe e realitetit të familjeve shqiptare, flitet shumë për gjithëpërfshirjen. Prindërit e fëmijëve me problem autike përballen me një traumën dërsa kalojnë nga cikli parashkollor në atë fillor. Ata i bëjnë vetes shumë pyetje, të cilat tregojnë, pavarësisht hapave të hedhur në këto vite, pasigurinë e sistemit arsimor në përballjen me çështje të tilla: "Ku do ta çoj fëmijën tim? A do të ma kuptojë mësuesja nevojën e tij të veçantë? A ka

ajo informacion për problemin e fëmijës dhe a di të merret me të? A do të ketë mësuese mbështetëse? A do të jetë ajo e duhura? A do të ma pranojnë shokët? Si do të sillen fëmijët e tjerë me të?"

Ashtu si çdo proces në fillimet e veta, gjithë përfshirja ka vështirësi të mëdha. Pikërisht përnjohur e studiuar këtë realitet të arsimit në qytet, studimi ynë ka marrë në konsideratë një numër prej 25 mësuesish të kopshteve e shkollave fillore të qytetit të Vlorës, të cilët punonin me fëmijë autikë si dhe 8 drejtues të këtyre institucioneve për t'ën johur në mënyrë sa më të gjerë realitetin e gjithë përfshirjes në shkollat e kopshtet e qytetit të Vlorës. Qëllimi ynë është që të njohim si është organizuar, si funksionon, e ku çalon sistemi, për të mundur që ,përmes njohjes, të ndërmarrim veprimet e duhura në instancat përkatëse, për të siguruar:

1. Përshtatjen e infrastrukturës mbështetëse për këta fëmijë që është e mangët dhe që mund të arrihet nga përfshirja e sa më shumë aktorëve, jo vetëm shtetit po edhe biznesit, komunitetit.
2. Trajnimin e mësuesve të ciklit parashkollor e fillor, në mënyrë që ai të jetë më pak teorik e më shumë praktik, si dhe të sqarojë përgjegjësinë personale e institucionale të detyrës së mësuesit, që në rastin e fëmijëve autikë, duhet të jetë e dhënë e lartë.
3. Bazën material didaktike të përshtatshme për të punuar me fëmijët autikë.

Është e qartë që autizmi sot është një problem i vështirë për t'u zgjidhur, por, a jemi duke ecur të sigurt në lidhje me të duke e vlerësuar për atë që është dhe duke vënë në dispozicion të gjitha mjetet e mënyrat e duhura të përballjes? Kjo është pyetja që merr përgjigje, të paktën për realitetin e qytetit të Vlorës. Vetëm të parit e gjërave siç janë, pa frikë dhe vërtetësisht, mund të na çojë përpara drejt zgjidhjes së problemeve.

Fjalëkyçe: autizëm, gjithëpërfshirje, shkollë, arsim special, integrim

MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE PBL (PROJECT BASED LEARNING)

Erviola Konomi

Universiteti i Tiranës

Fakulteti i Shkencave të Natyrës

erikonomi180@yahoo.com

Abstrakt

Gjatë dy dekadave të fundit, interesi për angazhimin e nxënësit në procesin mësimor është rritur. Nxënësit e angazhuar demonstrojnë përfshirjen e të nxënëit, sjellje dhe ton pozitiv emocional. Në anën tjetër, shumë mësues shpesh kërkohet të japin mësim në një kurrikulë të standardizuar dhe një pedagogji të caktuar në pjesën më të madhe të kohës së tyre të shpenzuar për matematikë dhe shkrim-lexim dhe që nuk kanë kohë ose autonomi për të përdorur pedagogjinë krijuese, ndërthurjen me artin

në programin e tyre, në përdorinë metodologjisë PBL në mësimdhënien e tyre. Ky studim është hartuar për të hetuar se si integrimi PBL në kurrikulum ndikon në angazhimin e nxënësve.

- Janë arritur kompetencat kryesore arsimore, më të rëndësishme për nxënësit që kanë përjetuar integrimin e PBL në kurrikulë për një ose më shumë vite se sa për ata që kanë pasur të njëjtën përvojë, por për më pak se një vit?
- A është niveli i angazhimit në procesin e të mësuarit për nxënësit që kanë integruar në artin, shkencën, Scientix, ose kanë përdorur mjete të ndryshme teknologjike, hulumtuese në studimin e tyre, (Shembull i mirë i PBL përmes projektit "Math and Successful Investor" gjatë gjithë programit për një ose më shumë vite se sa për studentët që kanë përjetuar vetëm artin e integrimin për më pak se një vit?)

Gjatë studimit pjesëmarrësit përfunduaran keta mbi angazhimet dhe detyra të nxënësit. Të dhënat e mbledhura u analizuan dhe zbuluan marrëdhënie të rëndësishme ndërmjet integrimin të PBL në kurrikulën dhe angazhimin e nxënësve në procesin mësimor.

Nëntemat:

1. Planifikimi i projekteve mësimore
2. Përmirësimi i motivimit të nxënësve
3. Projektet dhe Iniciativa

Metodologjia: hulumtuese, kërkimore, sasiore, cilësore.

Fjaletkyçe: projekt, eksper, gjithëpërfshirje, jetëreale, kurrikul, hulumtim.

MARRËDHËNIA MIDIS ORIENTIMIT TË QËLLIMIT, STRATEGJIVE TË TË NXËNIT VETËRREGULLUES DHE BINDJEVE MOTIVUESE NË LËNDËN E MATEMATIKËS TEK ADOLESHENTËT

Artë Dulaj

Universiteti i Prishtinës
Psikologji shkollore dhe këshillim
dulaja@hotmail.de

Abstrakt

Ky studim është dizajnuar për të gjetur marrëdhëniet midis orientimit të qëllimit, strategjive të të nxënit vetëregullues dhe bindjeve motivuese, përfshirë këtu edhe nivelin e edukimit të prindërve me variablat e përmendura më lartë. Ky studim është ndërseksional dhe është përdorur pyetësi Goal Orientation Scale (Midgley, Maehr, Hicks, Roeser, Urdan, Anderman, Arunkumar & Middleton, 1998) dhe Motivated Strategies for Learning Questionnaire (Pintrich & de Groot, 1990), ku është

përdorur Shkalla e Likertit. Kanë qenë 327 pjesëmarrës nga shkollat e mesme. Rezultatet kanë treguar se ekziston korrelacion pozitiv sinjifikant midis orientimit të qëllimit dhe strategjive të të nxënësve të vetërregullues (rs =.434). Korrelacion pozitiv sinjifikant midis orientimit të qëllimit dhe bindjeve motivuese (rs =.379) dhe poashtu korrelacion pozitiv sinjifikant midis strategjive të të nxënësve të vetërregullues dhe bindjeve motivuese është i rëndësishëm për nxënësit, që të jenë të mirë në lëndën e matematikës.

Fjalët kyçe: Të nxënësve, vetërregullimi, orientimi i qëllimit, motivimi, matematika, adoleshenca.

ESE MBI KRIZËN NË MAQEDONI

Migena Kashta

Universiteti i Vlores "Ismail Qemali"

migena.kashta2013@gmail.com

Abstrakt

Kjo punë fokusohet mbi një artikull gazetaresk, i cili flet mbi krizën në Maqedoni. Për fat të keq dhe pashmangshmërisht Shqipëria është e përfshirë në këtë krizë. Autori i artikullit është i shqetësuar në lidhje me këtë situatë, saqë i ka kushtuar një vend të vecantë opinionëve të disa organizatave shqiptaro-amerikane. Këto organizata shprehin me zë të lartë atë çfarë u duket e padrejtë. Përse Ballkani duhet të jetë gjithmonë ushqim për konflikte? Përse duhet të ekzistojë gjithmonë konflikti, i cili duket si gangrenë e vjetër që i ka hedhur thellë rrënjët në këtë rajon? Në këtë punë gjithashtu ka hapësirë edhe për opinionin tonë personal. Unë do të përpiqem të sjell në kujtesën tuaj një panoramë se si e kanë prezantuar veten shqiptarët në momente të vështira në lidhje me krizat etnike, fetare e më gjerë.

Fjalë celësa: krizë politike, ballkan, konflikt

ESE MBI REALITETET NË BALLKAN

Joana Sinovarfaj

Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali"

jsinovarfi@yahoo.com, jsinovarfi@gmail.com

Abstrakt

Fokusi i kësaj eseje është Ballkani dhe realiteti që po mbizotëron në të. Si janë transformuar vendet mbas pushtimit turk? Cila është marrdhënia midis tyre? Pse flitet për një luftë të tretë botërore që

është gati të shpërtheje dhe në qoftë se kjo gjë do të ndodhë, cilat janë vendet më të rrezikuara? Kur Bashkimi Europian u formua u premtua se asnjë vend nuk do të lihej jashtë kësaj organizate dhe vetëm disa vite më vonë BE deklaroi se nuk do të shkonte përgjatë një procesi zgjerues. Për më tepër u fokusua vetëm mbi problemet ekonomike të saj. Përse ndjehet në ajër frika e një lufte që mund të përfshijë jo vetëm Ballkanin por edhe të gjithë botën? E gjithë puna është përqëndruar mbi këto pyetje ku përveç mendimit tim do të analizohet dhe mendimi i kryeministrit të Suedisë Carl Bildt i shprehur në artikullin gazetaresk "Të mbash fantazmat e Ballkanit në kufi".

Fjalë kyce: Luftë, Ballkan, frikë, marrdhënie, pushtim, rrezik, premtim

METAPHYSICS IN EMILY DICKINSON

Ilina Pashaj

Bachelor thesis in Foreign Languages

Advisor : Prof.Assoc. Armela Panajoti

Abstract

This research paper focuses on one of the most fascinating authors that is considered as one of the great geniuses of the nineteenth –century American poetry, Emily Dickinson. It is difficult to tell which movement she fits into, because she has qualities from both literary movements, Realism and Modernism but many other critics also remark that Emily Dickinson's style is essentially metaphysical. This paper is an attempt to demonstrate the relation of Emily Dickinson with metaphysical poetry in the ways she explores the profound areas of experience. Metaphysical poetry is concerned actually with the whole experience of man. Like the poetry of metaphysical school of poets, her poetry is a union of thought and emotion. Analysis of her work reveals that her love poems and those that treat the problems of time and eternity are metaphysical in style and content. Therefore this paper discusses love and death closely related to immortality in Dickinson's poems.

RREZIKU I TRAFIKIMIT TE FEMIJEVE ME ANE TE PROCEDURAVE TE BIRESIMIT KOMBETAR DHE NDERKOMBETAR "BIRESIMI, HUMANITET APO KRIMINALITET?"

Emanuel PAPA

Kesion MALAJ

Fakulteti I Shkencave Humane

emanuel_papa@outlook.com

kesionm54@gmail.com

Abstrakt

Ne ditet tona fenomeni i biresimit po behet nje ndodhi qe sa po vjen dhe po shtohet. Si veprim, biresimi eshte ne radhe te pare nje akt human , "shpetimi" i nje femije nga jeta e mohuar e nje te tilli dhe rehabilitimi i tij perseri ne gjirin familjar te shoqerise dhe si i tille, duhet vleresuar ne shume dimensione , pasi rikthimin e statusin e jetes normale si femijenore dhe asaj familjare te nje femije , eshte dicka qe ndikon jo vetem ne jeten e atij femije , por edhe ne permiresimin e brezit te ardhshem. Pranojme faktin se shumica e largimive te femijeve nga gjiri familjar per ne shtepine e femijes, madje dhe per ne rruge ndodh dhe per shkak se kushtet familjare jane ndoshta ekstremisht te keqija. Keshtu, biresimi, nje teme qe, pavaresisht se ne ditet tona shikohet si nje dicka "normale" le te themi, fshehe nen "masken" e tij nje humnere tej mase te thelle krimi. Jane te shumta rastet sidomos ne familjet e varfra, qe femijet per te cilet nuk gjenden kushtet e jeteses nga ana e prinderve, "flaken" ose dorezohen si pako , ne shtepite e femijes apo ndoshta dhe me keq shiten, tek familjet e inkriminuara apo ato te cilat nuk mund te kene nje femije te tyre. Kushtet e trafikimit te femijeve ne rang kombetar dhe nderkombetar ditet e sotme kane aritur fshehtesine e duhur qe ne syte e publikut te shfaqen si nje akt i paster biresimi dhe buzeqeshja e atij "prindi" te ri eshte me se e mjaftueshme per ti shpetuar syve te ligjit. Sa eshte paresore interesimi i publikut ne kete fushe dhe cfare ndodhe me keta femije , te cilet perdoren per qellime nga me te keqijat. Per pasoje se ky krim, I ka shtrire rrenjet e tij thelle ne shoqerine tone dhe fshehtesia e tij eshte e tille qe normaliteti te mos e dalloje, ka bere qe pergjigjet e ketyre pyetjeve por edhe shume te tjera vete jane te veshtira per t`u dhene. Pavaresishte se strukturat shteterore ne mbare boten jane ne gadishmeri per luftimin e ketij krimi, perseri trafikimi i femijeve i fshehur nen "mantelin" human te biresimit mbetet nje ceshtje serioze per t`u shqetesuar .

Fusha: Drejtesi

Fjale kyce: Biresim, trafikimi njerezor, ligj

BIZNESET NDERKOMBETARE

Bleona Hoxha

Universiteti "Ismail Qemali"

Dega: Administrim Biznesi

bleonah28@gmail.com

Abstrakt

Shtetet e zhvilluara dhe shtetet e botes se trete mund te jene shume te ndryshem, por e perbashketa e tyre eshte ajo c`ka njerezit pelqejne me teper. Dhe ketu e kam fjalen per bizneset e famshme. Ato te cilat funksionojne ne te njejten menyre ne gjithe boten.

Klientet nuk vijne ne marketin apo restorantin tend vetem per produktin,ata vijne per marken,nje marke te cilen e kane me te degjuar sesa markat e tjera. E gjitha ka te beje me nje emer te madh,nje emer i cili tingellon madheshtor.

Ne qofte se je duke e zhvilluar biznesin tend nga kombetar ne nderkombetar,gjithashtu duhet te shesesh ose te japesh me qera edhe token tek biznesmenet e rinj,te cilet do te hapin nje filial te biznesit meme.Ne kete menyre do te posedoni gjera qe kushtojne shume me shume se produkti,keshtu do te perfitoni me shume dhe do ta keni te gjithë tregtine nen kontroll.

Nje biznes i frytshem nuk vepron gjithmone ne menyren qe promovohet para publikut,pasi cilesia kushton dhe eshte me ekonomike te perdoresh lende te para te pashendetshme dhe praktike,te cilat nuk kane nevojë per shume hapesire dhe per kushte specifike.Pervec cilesise njerezit preferojne dicka qe ka shije te mire,duket bukur ose thjesht I ben ata te ndjehen vetevetja.Ndonjehere kjo eshte gjithcka ata duan.

Eshte e vertete qe klienti eshte mbreti per nje biznes,por ne nuk jemi gjyshe qe te perkujdesmi,ne jemi manaxhere.Ne qofte se deshironi ushqim te gatuar si ne shtepi ose triko te thurura si nga gjyshja,nuk mund ti gjeni keto ne bizneset nderkombetare edhe pse mund ta degjoni si slogan gjate publicitetit.

Fjale kyce: nderkombetar,tregti,klient

SHËRBIMET E MIKROFINANCËS NË SHQIPËRI; STUDIM NË ZONAT RURALE TË FIERIT DHE VLORËS

Emanuel Pone

Universiteti "Ismail Qemali" Vlore.

Fakulteti: Ekonomik , dega Finance.

emanuelpone16@gmail.com

Abstrakt

Mikrofinanca sot është një nga shërbimet financiare më të rëndësishme dhe sociale në botë. Shërbimi i mikrokredive e ka zanafillën në kooperativat e krijuara në Evropë në fund të shekullit të XIX-të. Ajo konsiston kryesisht në dhënien e shumave të vogla të huas individëve që nuk kanë mundësi të marrin para hua në bankat tregtare.

Projekti i Kredisë Rurale, tani është institucionalizuar si "Fondi Besa". Ai u angazhua për krijimin e një sistemi financiar kooperativ, mbi bazën e eksperiencës botërore, mbështetjen e donatorëve e qeverisë, si dhe partneritetin e vërtetë me komunitetin rural.

Që prej vitit 2015 është implementuar nga qeveria shqiptare në bashkëpunim me BERZH, "Fondi Kombëtar i Garancisë për Kreditimin e Bujqësisë", duke iu dhënë keshtu fermerëve shqipëtarë një lehtësi shtesë në marrjen e mikrokredisë.

Nëpërmjet këtij studimi do të jepet një informacion mbi pikat kryesore të mikrofinancës dhe do të shikojm sesi realisht po përdoret ky fond nga SHKK-it, duke bërë një studim të një prej institucioneve të mikrofinancës në shqipëri "Fondit Besa".

Si rezultat nga studimi im kam përgatitur një punim me tre kapituj. Kapitulli i parë shtjellon mikrofinancën në zonat rurale. Kapitulli i dytë fokusohet te institucioni mikrofinanciar i marrë në studim, te FONDI BESA, ndërsa kapitulli i tretë përfshin paraqitjen dhe analizën e rezultateve nga pyetësi i shpërndarë te përdoruesit e mikrofinancës, si burim financimi dhe në fund konkluzionet. Pyetësi u shpërndarë gjatë muajëve maj-qershor 2017 në fshtrat e Fierit dhe Vlorës. Numri i personave të marrë në analizë është 70.

Fjalë kyçe: mikrofinanca(mikrokredia), fondi besa, institucionet mikrofinanciare.

PLANIFIKIMI FINANCIAR I FAMILJEVE NË SHQIPËRI: STUDIM NË QYTETIN E FIERIT

Xhensila Xhaferaj (Pone)

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.

Fakulteti Ekonomik, dega Finance

xhensilaxhaferaj13@gmail.com

Abstrakt

Planifikimi financiar i familjes është një praktikë, që ka fituar dhe vazhdon të fitojë popullaritet dhe më tej duke tërhequr vëmendjen e njerëzve në mbarë botën.

Edhe pse numri i planifikuesve financiar vazhdon të rritet çdo ditë, në Shqipëri ka ende shumë familje, që nuk e dinë rëndësinë e ndikimit të një planifikimi të saktë financiar, në të ardhurat dhe sigurinë e tyre financiare për të ardhmen.

Problemet financiare, që shqetësojnë shqiptaret jo gjithmonë lindin nga mungesa e parave, por kryesisht nga mungesa e informacionit të planifikimit të përdorimit të parave.

Punimi im është i strukturuar në tre kapituj dhe konkluzione. Kapitulli i parë përfshin konceptet kryesore mbi temën dhe arsyet e njohjes së financave personale; kapitulli i dytë është i fokusuar te shpenzimet për konsum në shqipëri sipas zerave, sipas viteve, si mesatare etj, ndërsa kapitulli i tretë është dedikuar konkretisht qytetit të Fierit përmes pyetësorit dhe analizës së tij.

Nëpërmjet këtij studimi synohet të njohim aftësitë e planifikimit financiar në familjet shqiptare dhe më saktësisht në familjet e qytetit të Fierit, duke bërë përzgjedhjen e literaturës dhe më pas konkretizimin e studimit nëpërmjet një pyetësi të shpërndarë në familjet e qytetit të Fierit.

Shpërndarja e pyetësorit është bërë gjatë muajve Mars-Prill-Maj, në 60 familje në qytetin e Fierit. Të dhënat e përfituara nga pyetësi janë grumbulluar, përpunuar dhe analizuar për të arritur në një përfundim konkret të paraqitur me tabelat dhe grafik.

Fjalekyce: planifikim financiare, keshillues financiare, strukture shpenzimesh, buxhet familjare, financa personale.

CITY TOILET

Adelisa Madani, Kejda Beqiri
Universiteti "Aleksandër Moisiu"
Fakulteti i Biznesit
Dega Bankë-Financë
adelisa.madani1@gmail.com
kejdabeqiri@gmail.com

Abstrakt

Durrësi është qyteti i dytë për nga madhësia dhe rëndësia në Republikën e Shqipërisë. Një nga sfidat më të mëdha që përcaktojnë dhe zhvillimin e ardhshëm të këtij vendi është ofrimi i shërbimeve që do ta çojnë këtë vend në një stad më të lartë kombëtar, por jo vetëm. Në bazë të analizave dhe studimeve që kemi bërë kemi ardhur në përfundim se një shërbim shumë i rëndësishëm që i mungon këtij qyteti është ofrimi i tualeteve publike. Ndërsa ekonomia shqiptare po zgjerohet gjithnjë e më shumë ndaj botës, në termat e ekonomisë dhe investimeve të huaja, nevoja e krijimit të këtyre tualeteve shihet si një domosdoshmëri edhe në terma afatgjatë për qytetin. Në hartimin e këtij projekti, jemi bazuar në të dhënat që kemi marrë nga biznese të ngjashme që operojnë në Shqipëri apo mbarë botën, si dhe në kërkesën e banorëve, vizitorëve dhe turistëve të qytetit. Ne kemi menduar të investojmë në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tualeteve publike të cilat mungojnë në qytetin e Durrësit. Ky biznes është një domosdoshmëri për qytetin, pasi u vjen në ndihmë të gjitha shtresave dhe moshave dhe është një shërbim më shumë ndaj qytetarëve. Për t'u informuar më tepër rreth këtij biznesi ju ftojmë të lexoni më gjerësisht planin tonë të biznesit.

Fusha: Biznes

Fjalë kyç: kërkesë, shërbim, investim, plan biznes, terma afatgjatë.

HOLOGRAMET DHE NDIHMESA E TYRE NE MESIMDHENIE

Hilari Rapushi

Universiteti "Ismail Qemali"
Dega: Shkenca kompjuterike
hilari.rapushi@gmail.com

Abstrakt

Hologrami është një projektimi 3D i një imazhi.

Mesuesit mund të jenë në shumë vende njëkohësisht duke përdorur teknologjinë holografike. Lidhja gjeografike midis klasave dhe është mënyra më e mirë për shkëmbim kulturor pa qene e nevojshme të qenit në vendin e caktuar. Kur kjo teknologji të behet ekonomike, kur çdo njeri mund të arrijë ta blejë, atëherë dhe nxenesit mund të kenë një projektor të vogël me vete. Në mjeksi ndihmon në rastin kur tregohet anatomia e trupit të njeriut apo në kimi ku mund të tregohen rrjetat kristalore apo struktura e polimereve. Në gjeografi me anë të hologrameve mund të tregohet shtrësat e tokës apo atmosferës, apo se si krijohet një termet apo fosilet e ndryshme. Arkitektet e ardhshëm e kanë shumë të lehtë projektimin e një ndërtese në të gjitha drejtimet .

Disavantazhet.

Duke filluar nga çmimi i lartë i një aparati Holografik (nga \$500-\$100.000). Një tjetër problem që do të shfaqet është edhe mospërkohshmëria e shkollës nga studentet kur secili të marrë një aparat holografik. Teknologjia e Holografikes është një teknologji në zhvillim kështu që nuk do të ishte shumë e sigurt që të implementohet në shkollë. Një tjetër problem që lind përse i përket kësaj teknologjie është pjesa e interaktivitetit të studentit dhe mesuesit që sjell mbingarkesë në rrjet.

TOPONIMIA E FSHATIT DUKAT

Rajmonda Kashuri

Universiteti "Ismail Qemali"
Departamenti i gjuhës shqipe dhe letërsisë
rajmondakashuri7@gmail.com

Abstrakt

Toponimia e një fshati a e mbarë një vendi paraqet një interes të madh për shumë degë të shkencës si p.sh. për gjuhësinë, etnologjinë, studimin e legjendave, problemeve mjaft të gjera të fshehtësisë së historisë, historinë e vendbanimeve të krahinës a vendit përkatës. Toponimia e Dukatit është jo vetëm e pasur, por edhe e shumëllojshme. Brenda saj grupohen toponime të lashta, por edhe mjaft toponime të reja, madje të fundviteve. Gjatë këtij studimi të shkurtër, kam hasur në

disa toponime me dy variante të gojëdhënave e ndoshta po të kisha mundur të merrja dëshmi të tjera nga më të vjetrit, mund të gjendej edhe ndonjë alternativë tjetër. Gjithsesi, këto dëshmi, këto alternativa përfundojnë në faktin se toponimia e Dukatit është shumë e hershme. Brenda saj gjenden toponime me prejardhje sllave si "moçal", por edhe toponime ku ka vetëm prapashtesë sllave. Kemi toponime me prapashtesë latine, raste të tjera ku toponimet shpjegohen me turqishten apo serbokroatishten. Vëmë re se më së shumti, se toponimia e vendeve të marra në studim shpjegohet me gjuhën shqipe dhe elementët e saj, elementë këta që janë pjesë e shqipes së sotme, por edhe elementë të cilët janë dëshmi e analogjive me ilirishten, siç ishte rasti i prapashtesës –at < -atës (Dukat). Megjithatë, mund të themi se, pavarësisht elementëve të huaj të hasur në toponiminë e zonës, aty mbizotëron elementi shqiptar, duke dëshmuar kështu autoktoninë shqiptare të këtyre viseve dhe banorët e tyre.

Fusha: gjuhësi

Fjalë kyç: toponim, vendbanim, strukturë, elementi sllav, latin, toponimi shqiptare.

MIXED REALITY TECHNOLOGY BREAKTHROUGHS

Denis B. Sinanaj

Universiteti "Ismail Qemali"

denissinanaj@gmail.com

Abstract

Mixed reality (MR) is a kind of virtual reality (VR) but a broader concept than augmented reality (AR), which augments the real world with synthetic electronic data. On the opposite side, there is a term, augmented virtuality (AV), which enhances or augments the virtual environment (VE) with data from the real world. Mixed reality covers a continuum from AR to AV. Advances in AR and VR promise to change the way we interact with technology. Though consumer buzz surrounding devices designed for gaming and entertainment is growing, AR's and VR's enterprise potential is proving to be the real cause for excitement. In this paper we will represent keypoint of advances in following: MR image capture and encoding technology, MR streaming and display technology, MR applications.

Keywords: Mixed reality, virtual reality, augmented reality, Continuum, 3-D video encoding, 3-D image display, HMD devices

A DUHET TË BIRËSOHEN FËMIJË NGA ÇIFTET HOMOSEKSUALE?

Lavdie Maraj

Sabina Shaqiri

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

ledimaraj5@gmail.com

Abstrakt

Vitet e fundit fenomeni i homoseksualitetit ka fituar një ndjeshmëri të dukshme. Disa shtete në Europë kanë legalizuar martesat midis personave të të njëjtit seks. Shqipëria po njeh një rritje të ndjeshme të numrit të çifteve homoseksuale. Me qëllim krijimin e një kornize familjare të plotë, shumë prej çifteve homoseksuale u drejtohen procedurave përbirësimin e fëmijeve. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë interesin më të lartë të fëmijes mundësia birësimit të tij nga një çift homoseksual. Analiza interpretuese dhe krahasimore e legjislacioneve të ndryshme evropiane dhe studimi i rasteve praktike gjyqësore janë metodat e përdorura në këtë punim.

Fusha: drejtësi

Fjalë kyçe: çifte homoseksuale, fëmijët, birësimi, interesi më i lartë i fëmijës.